



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KUVENDI**

*Komisioni i Posaçëm për Reformën në Sistemin e Drejtësisë*

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 06.07.2016, ora 10:00

**Drejton mbledhjen:**

**Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit**

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të komisionit.
2. Prezantimi i projektligjit “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”,
3. Prezantimi i projektligjit “Për rivleresimin kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në RSH”.
4. Vazhdimi i shyrtimeve nën për nën të projektligjit “Për Statusin e Gjyqtarit dhe Prokurorit në Republikën e Shqipërisë”.

**Marrin pjesë:**

Fatmir Xhafaj, Pandeli Majko, Ulsi Manja, Vasilika Hysi, Petrit Vasili dhe Vexhi Muçmata.

**Mungon:**

Oerd Bylykbashi, Spartak Braho, Keltis Kruja, Arben Ristani, Gent Strazimiri, Fatmir Mediu.

**Të ftuar:**

Rainer Deville – ekspert i Nivelit të Lartë, shef i misionit të EURALIUS-it në Shqipëri

John Smibert – ekspert i Nivelit te Larte, përfaqësues i misionit të OPDAT-it në Shqipëri

Agnes Bernhard – eksperte e Nivelit te Larte, zëvendësshefe e misionit të EURALIUS-it në Shqipëri

Korajlka Bumçi - eksperte e Nivelit te Larte, përfaqësuese e misionit të EURALIUS-it në Shqipëri

Aurela Anastasi - eksperte e Nivelit te Larte

Arben Rakipi - ekspert i Nivelit te Larte

## HAPET MBLEDHJA

**Fatmir Xhafaj** - Kuorumi për të zhvilluar mbledhjen është realizuar, kështu që mund të çelim mbledhjen e sotme të Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën në Drejtësi.

Sot si pikë të parë të rendit të ditës kemi prezantimin e dy projektligjeve. Fillimisht projektligjin për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar dhe pastaj pas tij kemi projektligjin për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.

Sot do të dëgjojmë prezantimin e dy projektligjeve sipas kësaj radhe që parashtrova. Kolegët mund të bëjnë pyetje për çështje që janë të natyrës të përgjithshme të projektit dhe në ditët në vijim, sipas kalendarit, duhet të jetë qëndrimi i relatorëve, përkatësisht zotit Manja për projektligjin e parë dhe zotit Majko për projektligjin e dytë, diskutime në parim, votim në parim dhe pastaj shqyrtimi nën për nën. Janë projektligje shumë të rëndësishme për shkak jo vetëm të rëndësisë që kanë në vetvete, por edhe lidhjes së drejtëpërdrejtë që kanë me implementimin e projektit kushtetues për reformën në sistemin e drejtësisë.

Fillimisht do të dëgjojmë një paraqitje të projektligjit të parë, pra për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar nga ekspertët e nivelit të lartë.

Janë të pranishëm zoti Smibert, që është njëkohësisht edhe përfaqësues i OPDAT-it, i cili është edhe bashkëdrejtuesi i këtij grupi pune, zonja Bumçi, e cila është pjesë e grupit të punës dhe njëkohësisht eksperte e nivelit të lartë nga EURALIUS-i, zoti Rakipi, i cili është pjesë e grupit për drejtësinë penale dhe për grupin që ka punuar për projektligjet e shtyllës së komponentit, që ka të bëjë me antikorrupsionin. I falënderoj të tre për prezencën, madje falënderoj të gjithë ekspertët e nivelit të lartë, ekspertët të sekretariatit teknik, ata që kanë marrë pjesë në grupin e *think tank*-ut të posaçëm, ngritur për këtë projektligj, të gjithë ata që kanë kontribuar në tryezat e konsultimit për përsosjen e mëtejshme të këtij projektligji, ekspertët e ministrisë së Drejtësisë që kanë dhënë kontributet e tyre dhe mbështetjen ndaj këtij projektligji, si dhe stafin tonë të Kuvendit, që gjithashtu ka shërbyer dhe ka ndihmuar për ta lehtësuar punën e të gjithë këtyre njerëzve në shërbim të këtij projekti, si dhe shumë projekteve të tjera që kemi në proces shqyrtimi.

Atëherë, mund të dëgjojmë prezantimin e projektligjit, besoj se zoti Smibert ka diçka.

**Jon Smibert** – *(flet anglisht)* Mirëmëngjesi!

Faleminderit!

Fillimisht do të doja të falënderoja njerëzit të cilët kanë punuar me këtë ligj, kryesisht zonjën Bumci, zotin Rakipi, zotin Artan Hoxha, që ka kontribuar gjithashtu për këtë ligj.

Për të bërë një përshkrim të përgjithshëm për atë çfarë ka ndodhur, për përfshirjen e institucioneve të ndryshme, kemi organizuar *think tanke*-et në fillim të muajit maj për të konsoliduar disa nga opinionet që kanë ardhur nga Ministria e Drejtësisë, nga prokuroritë dhe nga kontribuues të tjerë për këtë projektligj. Kemi pasur konsultime publike në Durrës, me 12 dhe 13 maj në Tiranë, ku në të gjithë këto takime është ftuar edhe opozita për të marrë pjesë. Jemi përpjekur të integrojmë sa më shumë të mundemi edhe opinionet e tyre gjatë rrugës në këtë projektligj.

Një përshkrim i përgjithshëm i këtij ligji ka të bëjë me kapitujt e tij. Kapitulli i parë jep parimet e përgjithshme, i dyti jep kompetencat se cilat do të jenë dy gjykatat e specializuara për antikorrupsionin dhe krimin e organizuar, duke iu referuar edhe Kodit të Procedurës Penale. Kjo do të thotë që, përveç këtij ligji, edhe Kodi i Procedurës Penale duhet të amendohet për t’iu përshatur ndryshimeve kushtetuese. Gjithashtu, ka edhe parashikime të tjera për prokurorinë e veçantë, për Byronë Kombëtare të Hetimit dhe të gjitha parashikimet gjenden në nenin 74, germa “a”, por edhe një sërë parashikimesh të tjera për këto krime, duke përfshirë edhe kompetencat kryesore.

Kapitulli 3 bën një përshkrim të Prokurorisë së Përgjithshme, ku në shumicën e këtyre rasteve prokuroria është e shkëputur nga prokurori i Përgjithshëm, është pjesa që merret me mënyrën se si njerëzit do të përcaktohen nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, si dhe ligje të tjera, të cilët janë paraqitur përpara këtij komisioni. Kapitulli katër merret me pjesën se si prokuroria speciale do të mbulojë edhe organe të tjera të qeverisë.

Kapitulli pesë mbulon pjesën e Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe ky ligj ka nisur me draftin fillestar të disa kohëve më përpara. Gjithashtu, jemi konsultuar me Ministrinë e Punëve të Brendshme për këtë gjë, me opozitën dhe gjatë rrugës u zhvillua më tej edhe ligji për Policinë Gjyqësore. Jemi përpjekur që të gjitha këto koncepte të jenë të përputhshme me njëra-tjetrën. Ka pjesë të ligjit që duhet të korrespondojë me ligjin për Policinë Gjyqësore dhe duhet të jenë në përputhje me njëra-tjetrën.

Kapitulli gjashtë merret me personelin e Byrosë Kombëtare të Hetimit, për kushtet e sigurimit të të gjithë anëtarëve të këtij ekipi. Për këtë arsye ka edhe dispozita në lidhje me këtë, si dhe disa dispozita në kapitullin shtatë për sa i përket sigurisë së personave dhe të godinave.

Pjesa e fundit është kapitulli nëntë, në të cilin parashikohen ato dispozita që kanë të bëjnë me kushtet e sigurisë, besimit dhe konfidencialitetit, me fjalë të tjera, se si gjyqtarët, prokurorët, hetuesit dhe i gjithë personeli, pra BKI-ja, do të monitorohet në të njëjtën mënyrë, ashtu sikurse monitorohet USKAK në Kroaci dhe DNA-ja në Rumani. Zgjidhjet që gjenden në këtë kapitull janë rishikuar. Në lidhje me këtë kemi edhe dispozita të tjera në kapitullin e 10-të. Pra, kjo është mënyra sesi ne e kemi paraqitur ligjin. Aty mund të gjeni të gjitha shënimet shpjeguese, të cilat përshkruajnë mënyrën e arsyetimit dhe qëllimin e secilit prej këtyre neneve.

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit për prezantimin e përmbledhur që i bëtë përmbajtjes së projektligjit. Projektligji është në dispozicion të deputetëve për shqyrtim, për debat dhe për miratim.

Mund të vazhdojmë. Kush ka pyetje? Po, zoti Manja.

**Ulsi Manja** – Faleminderit!

Përgëzoj gjithë ekspertët, por edhe gjithë aktorët e tjerë të sistemit të drejtësisë që janë bërë pjesë e hartimit të këtij projektligji. Natyrisht që ligji “Për Prokurorinë e Posaçme” dhe ligji “Për Njësinë e Posaçme Hetimore”, së bashku përbëjnë atë që quhet SPAK. Ndoshta, së bashku edhe me ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” përbëjnë thelbin e reformimit dhe rimodelimit të sistemit të drejtësisë penale në Shqipëri pas ndryshimeve të rëndësishme që janë propozuar në draftin kushtetues lidhur me përcaktimin e prokurorisë. Prokuroria tani, në Republikën e Shqipërisë përcaktohet si një organ i pavarur, që garanton mbarëvajtjen e punës së prokurorisë, por edhe respekton pavarësinë e brendshme të prokurorëve në ushtrimin e ndjekjes penale dhe në përfaqësimin e akuzës në gjyq.

Në tërësi e përgëzoj projektligjin, por, natyrshëm, për të qartësuar veten, kolegët, por edhe më gjerë sesa kaq, duke qenë se së bashku me kolegun Muçmata vijmë nga fusha e prokurorisë dhe shumë nga këto gjëra që janë përcaktuar në ligj për ne janë edhe të prekshme, kemi edhe shqetësimin që mund të ketë një prokuror në raport me ligjin, por edhe me aplikimin praktik të këtij projektligji, sepse nesër, kur të marrë votën e parlamentit, me këtë ligj do të punojnë një komunitet i gjerë prokurorësh dhe oficerësh, dhe ka gjëra që duhen qartësuar.

Pyetja ime ka të bëjë me Byronë Kombëtare të Hetimit. Sot, Kodi i Procedurës Penale, kuadri ligjor në fakt që normon punën e Policisë Gjyqësore, përbëhet nga Kodi i Procedurës Penale, ligji që përcakton kompetencat e Policisë Gjyqësore në mënyrë të përmbledhur, është ligji për Policinë Gjyqësore, por edhe ligji për prokurorinë. Ky është korpusi ligjor sot.

Pyetja ime është e tillë: në Kodin e Procedurës Penale përcaktohet që policia gjyqësore organizohet në seksione, përbëhet nga seksionet e policisë gjyqësore dhe shërbimet e policisë gjyqësore, të cilat janë të organizuara dhe funksionojnë pranë çdo prokurorie rrethi. Në ligjin për Policinë Gjyqësore është parashikuar në mënyrë të detajuar roli dhe kompetencat e saj, gjithashtu është përcaktuar edhe raporti i seksionit të policisë gjyqësore me shërbimet e policisë gjyqësore. Në rast se do ta marrim siç e përcakton ligji që kemi sot, si një strukturë *lex specialis*, pra që Byroja Kombëtare e Hetimit do të funksionojë pranë prokurorisë së posaçme dhe do të merret vetëm me hetimin e veprave penale të korrupsionit dhe të krimit të organizuar dhe nuk do të ketë asnjë influencë nga jashtë, pra, do të jetë thjesht një strukturë në dispozicion të kësaj prokurorie, në çfarë raporti qëndron kjo strukturë me Policinë Gjyqësore, që sot është në dispozicion të një prokurorie rrethi? Cila është e veçanta e kësaj strukture në raport me strukturat e tjera të Policisë Gjyqësore që do të shërbejnë pranë prokurorisë së rrethit? Pra, përveç lëndës, çfarë e bën të veçantë këtë strukturë?

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit! Kush do të përgjigjet?

**Jon Smibert** – (*flet anglisht*) Do t'ia lë disa nga përgjigjet edhe kolegëve të mi, sepse këtu përfshihet edhe Kodi për Procedurën Penale, që mbulon këtë gjë, gjithashtu ka edhe draftin përkatës për Policinë Gjyqësore, por mendoj se pyetja e parë që do të doja të përgjigjesha, është pyetja e fundit që ju drejtuat, çfarë e bën këtë strukturë të veçantë dhe gjithçka tjetër buron nga kjo më pas.

Policia Gjyqësore i përgjigjet strukturës së prokurorisë për çdo nivel, por edhe çdo prokuror duhet t'i japë llogari një prokurori më të lartë. Pra, është një strukturë, ku çdo gjë i kthen përgjigje dhe i jep llogari një strukture qendrore. Ajo çfarë është e veçantë për SPAK-un, Prokuroria Speciale dhe Byroja Ndërkombëtare e Hetimit, është fakti që është e pavarur nga kjo strukturë, pra Byroja Ndërkombëtare e Hetimit është e pavarur dhe gjithashtu ka mbështetje nga Shtetet e Bashkuara dhe FBI-ja, duke përfshirë trajnimet dhe pajisjet për mbështetjen është përgatitur një projekt.

Qëllimi është që Policia Gjyqësore do të ketë shumë më tepër trajnime, ekspertizë që do t'i ofrohet në një fushë të caktuar. Kështu që e veçantë do të jetë sepse do të marrë shumë trajnime për t'u bërë pjesë e strukturës dhe, gjithashtu, do të veprojë në orientimin e prokurorisë së veçantë të specializuar. Gjithçka tjetër për ligjin dhe strukturën e Policisë Gjyqësore dhe mënyrën sesi do të përfshihet me Byronë Kombëtare të Hetimit, kush do të përgjigjet për këtë gjë? Ndoshta do të bazohemi te Kodi i Procedurës Penale për këtë gjë? Mendoj se keni të drejtë që identifikoni faktin se ka ligje të tjera që inkorporohen këtu.

Për sa i përket Kodit të Procedurës Penale, kjo është në paketën e dytë, nëse nuk gaboj. Po punojmë për Kodin e Procedurës Penale ende dhe të gjitha ndryshimet që do të jenë të nevojshme, do të reflektohen atje. Ka shumë ndryshime që janë të nevojshme jo vetëm në nenin 75/a, por edhe në nenet e tjera. Duhet të përshtatim Kodin e Procedurës Penale me ligjin e prokurorisë dhe, gjithashtu, duke u bazuar edhe te ndryshimet /amendamentet kushtetuese, do të kemi një prokurori dhe strukturë të pavarur. Të gjitha këto do të reflektohen në Kodin e Procedurës Penale. Kur flasim për Policinë Gjyqësore, nënkuptojmë që është pjesë e së njëjtës paketë, është përgatitur edhe projektligji përkatës për këtë seksion për diskutim brenda grupit të punës, por ky ligj është ende pezull, pasi ky ligj mbështetet te ligjet e paketës së parë, ndaj edhe nuk jemi futur në detaje, edhe pse ligji është në strukturë. Pra, kur të përfundojë paketa e parë, atëherë do të flasim për të njëjtën problematikë që do të diskutohet në ligjet paralele të paketës së dytë. Faleminderit!

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit!

Fjala për zotin Rakipi.

**Arben Rakipi** – Faleminderit, kryetar!

Lidhur me shqetësimin e shprehur nga deputeti Manja për mënyrën sesi është organizuar Byroja e Hetimit.

Ai ka eksperiencën e punës dhe ka konstatuar se në këtë ligj nuk i jemi përmbajtur ndarjes tradicionale ndërmjet seksioneve dhe shërbimeve. Ne kemi menduar që Byroja e Hetimit të konsiderohet një seksion, në qoftë se mund ta përdor këtë fjalë, por nuk quhet tërësisht kështu, që të përbëhet nga specialistë të fushave të ndryshme. Baza, sigurisht, do të jetë arsimi policor, por parashikon edhe specialistë të tjerë, të cilët mund të vijnë nga financat, pastrimi i parave e të tjera. Thelbi i pyetjes qëndron në faktin e lidhjes ndërmjet këtij seksioni, siç do ta quajmë, me

shërbimin: si do të veprojnë Policia e Shtetit ose policitë e tjera në vend në rastet kur bien në kontakt me një vepër, hetimin e së cilës e ka kompetencë Prokuroria e Posaçme?

Në nenet 29, 30, 31 e të tjera ligji ka parashikuar mënyrën si veprohet, si kalon çështja nga Policia e Shtetit te struktura e posaçme. Ajo që duhet thënë këtu, në përgjigje të drejtpërdrejtë të asaj pyetje, është se Policia e Shtetit ose policitë e tjera nuk do të kenë shërbime që janë të emëruara për t'i shërbyer këtij seksioni, flasim gjithmonë për shkak të këtij ligji. Mënyra se si organizohet Policia e Shtetit ose policitë e tjera në vend janë çështje të ligjeve përkatëse që i kanë formuar ato polici. Ligji në fjalë nuk flet për këto shërbime, por për mënyrën se si bashkëpunon Byroja e Hetimit të seksionit përkatës me oficerët e Policisë së Shtetit dhe më pas jep disa kritere që duhet të përmbushin oficerët e Policisë së Shtetit për të bashkëpunuar me këto seksione. Përgjithësisht janë të njëjtat kritere që duhet të përmbushin edhe oficerët e policisë, që do të punojnë pranë seksionit përkatës.

Pse është bërë kjo zgjidhje? Kjo zgjidhje ka nevojën imediate që ne kemi pasur, të evitimit të përçarjes ndërmjet hetimit dhe procedimit. Një nga të metat thelbësore të hetimit penal, që ne kemi konstatuar në analizën e materialit paraprak në procesin fillestar të reformës ka qenë pikërisht fakti se ka një ndarje të dukshme jo ligjore ndërmjet hetimit dhe procedimit, madje edhe publiku e di shumë mirë, jo vetëm specialistët. Nevoja për ta evituar këtë ndarje na ka çuar në variantin që prokurori duhet të ketë një strukturë të qëndrueshme të specializuar të posaçme pranë tij, të formuar nga specialistë të ndryshëm, të emëruar prej tij, të komanduar prej tij nën udhëheqjen e Kodit të Procedurës Penale dhe ligjit përkatës, por që të përmbushë nevojën e domosdoshme që hetimi të jetë bashkë me procedimin. Kjo ka qenë thelbësore dhe me këtë zgjidhje askush nga ne nuk ka pasur ndër mend t'i hiqte Policisë së Shtetit ose policive të tjera në vend detyrimin që kanë për të përmbushur kompetencën dhe detyrat e tyre të përditshme në luftën ndaj krimit të organizuar. Por, e përsëris, mënyra se si ato do të formohen janë çështje të ligjit përkatës. Me aq sa ne kemi dijeni, policitë në vend, sidomos Policia e Shtetit, kanë struktura të ngritura dhe mund të funksionojnë më mirë se sot, ashtu si sot, si dje, ashtu siç mund të përmbushin detyrat.

Prokurori i Posaçëm është i organizuar në këtë mënyrë. Ka edhe një arsye tjetër, që e ka bërë Byronë e Hetimit të lidhur ngushtë 100% me Prokurorinë e Posaçme, është kompetenca. Kompetenca është e atillë, që i mëshon faktit të procedimit për raste korrupsioni, ka merakun se oficerët e policisë duhet të jenë të emëruar nga prokurori, sepse lënda me të cilën do të merren



është pikërisht administrata publike dhe, për rrjedhojë, frika e ndikimit të kësaj administrate në këtë polici, na ka bërë të mendojmë se kjo është zgjidhja më e mirë.

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit!

Zoti Manja, keni pyetje tjetër?

**Ulsi Manja** – Jam dakord me këtë mënyrë shpjegimi, por kam një pyetje më të thjeshtë: sot Policia e Shtetit ka departament të hetimit të krimit të organizuar dhe korrupsionit, dhe do ta ketë, sepse është në misionin e Policisë së Shtetit. Një nga detyrat e Policisë së Shtetit është parandalimi i veprave penale, korrupsionit, krimit të organizuar, akteve terroriste e kështu me radhë. Ky departament do të vazhdojë të funksionojë në Policinë e Shtetit, por jo vetëm aty, sepse struktura të hetimit të veprave penale të korrupsionit dhe të krimit të organizuar ka edhe... Në funksion të kësaj është edhe Drejtoria e Pastrimit të Parave, doganat, tatimet dhe të gjitha agjencitë ligjzbatuese në vend.

Si do të jetë bashkëpunimi i këtij departamenti me seksionin e Policisë Gjyqësore të Byrosë Kombëtare të Hetimit? Pavarësisht se ligji është kujdesuar që në nene të caktuara ta institucionalizojë marrëdhënien e agjencive me Byronë Kombëtare të Hetimit nëpërmjet miratimit të rregulloreve të përbashkëta, por si është menduar nga ekspertët evitimi i një farë xhelozie institucionale që mund të lindë ndërmjet këtyre agjencive të zbatimit të ligjit në sferën e luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar? Si do të shkojë?

Ne sot kemi dy mënyra klasike të fillimit të çështjes penale: në Kodin e Procedurës Penale thuhet: “Me iniciativë”, por “Edhe me njoftimin e bërë nga të tjerët”. Unë e kuptoj që kjo strukturë do të veprojë me iniciativë, njësoj si të gjitha shërbimet e tjera të Policisë Gjyqësore, por e kam merakun te “njoftimi nga të tjerët”. Këtu e kam fjalën për Policinë e Shtetit, doganat, tatimet, Drejtorinë e Parandalimit të Pastrimit të Parave e kështu me radhë. Pra, si do të jetë bashkëpunimi ndërmjet këtyre institucioneve me Byronë Kombëtare të Hetimit dhe si mund të eliminohet një farë “xhelozie” për suksesin, sepse për dështimet nuk bëhen palë, të gjithë ikin.

Faleminderit!

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit!

Urdhëroni!

**Arben Rakipi** – Kjo pyetje është derivat i asaj që thamë në fillim. Në eventualitetin që zgjidhja që ne kemi paraqitur qëndron kështu, automatikisht strukturat e tjera ngelen jashtë përfshirjes në hetimin e çështjeve të tilla.

Unë e përsëris që nenet 29, 30, 31 e të tjera kanë mënyrën e bashkëpunimit me strukturat e tjera policore, të cilat, për shkak të ligjit, kanë detyrimin të hetojnë rastet penale, për aq sa kanë kompetencë edhe në përputhje me këtë ligj, pavarësisht nga kompetenca e gjykatës përkatëse. Pra, nëse Policia e Shtetit do të bjerë në kontakt me kryerjen e një vepre të krimit të organizuar, për aq sa e detyron ligji, ajo duhet të kryejë veprime dhe t'ia dërgojë strukturës përkatëse kundër krimit të organizuar. Kjo është lidhja dhe këtë e parashikon ligji. Unë e kuptoj që çështja e ligjit është tjetër dhe tjetër është çështja praktike.

Nëse do të ketë rivalitet ose jo, kjo çështje nuk vihet në dyshim, por një nga të këqijat e kësaj zgjedhjeje është se struktura që kemi paraqitur ne qëndron më vete, tërësisht përgjegjëse për kompetencën ligjore që i ka dhënë Kushtetuta dhe do të përgjigjet përpara publikut. Mekanizmat e tjerë të përgjegjësisë, që ne i kemi parashikuar në këtë strukturë janë: përgjegjësia para publikut, para parlamentit, para institucioneve të tjera. Kështu që kjo strukturë është totalisht përgjegjëse për këtë lloj juridiksioni, edhe në kuptimin politik përpara publikut. Kjo zgjedhje është bërë. Nëse parlamenti do të ketë nevojën ose domosdoshmërinë për të pasur mekanizma se si ta kontrollojë, kjo është çështje e dispozitave të tjera, jo të këtyre që po flasim, por edhe e dispozitave që lidhen me ligjin për prokurorinë.

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit!

Ka pyetje të tjera?

Urdhëroni, zoti Muçmataj!

**Vexhi Muçmata** – Faleminderit, kryetar!

Falënderoj edhe grupin e ekspertëve për punën e kryer në hartimin e projektligjit!

Pyetja ime është: sipas projektligjit rezulton se prokurorët e Prokurorisë së Posaçme janë të pavarur edhe nga vetë drejtuesi i prokurorisë. Në këtë kontekst ligjor a krijohet mundësia që 1, 2, 3 ose më shumë prokurorë të kësaj strukture, gjatë veprimtarisë hetimore dhe operacionale, të kryejnë veprime abuzive, si për shembull: të mos kryejnë hetime të plota, të mos administrojnë provat e duhura, të fshehin prova nën ndikimin politik, ekonomik ose shoqëror ndaj personave që e kanë këtë? A keni menduar ndonjë zgjidhje ligjore për të parandaluar këtë fenomen që mund të ndodhë në të ardhmen?

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit!

Urdhëroni, zonja Bumçi!

**Korajlka Bumçi** – *(flet anglisht)* Unë do t'i përgjigjem kësaj pyetjeje dhe më pas mund t'ia kaloj mikrofonin edhe Johnit.

Ne kemi parashikuar që, së pari: ky ligj duhet parë në kombinim me ligjin “Për prokurorinë”. Në përgjithësi është i lidhur kryesisht me ligjin “Për prokurorinë” dhe me udhëzimet e përgjithshme që janë të parashikuara dhe përbëjnë diçka që duhet të reflektohet edhe në këtë ligj. Të dyja këto duhen parë së bashku.

Së dyti, çdo prokuror i veçantë që punon te SPAKU është përgjegjës ose duhet të japë llogari te kryetari i SPAKU-t, prandaj nuk mund të themi se ai është i pavarur dhe mund të bëjë çfarë të dojë.

Tjetra, ai do të kontrollohet gjatë gjithë kohës, do të bëhet edhe kontrolli për sigurinë dhe çdo vendim që ai merr për pushimin e çështjes bëhet nëpërmjet trupës kolegjiale. Ai nuk mund të bëjë çfarë të dojë, ka pavarësinë e tij, por mban edhe përgjegjësi për këtë pavarësi.

Një tjetër aspekt i asaj që përmendi Kora është se ata janë përgjegjës edhe në dy mënyra të tjera. Mënyra se si është hartuar: prokurori dhe kryeprokurori mund të korruptohen në çfarëdolloj institucioni dhe për këtë arsye ju duhet të keni dikë në dispozicion, që të jetë i pavarur, të mos ketë nevojë që prokurori ose kryeprokurori të miratojë atë që bën ai në punën e tij. Për këtë arsye kemi, së pari, përgjegjësinë kriminale penale që mund të vijë nga kjo. Mund të kemi 1 ose 2 prokurorë, të cilët bëjnë abuzime për para apo për arsye të tjera dhe ata refuzojnë që të ndjekin penalisht diçka. Në Rumani kishim një prokurori të posaçme vetëm për këtë gjë. Pra, është një model i sjellë nga një model tjetër ekzistues.

Së dyti, ka edhe disa përgjegjësi disiplinore, të cilat janë në Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe këtu përcaktohet nëse këta prokurorë nuk po bëjnë aktivitetin që duhet të bënin. Atje mund të tregosh nëse ata janë duke marrë para ose mund të sjellësh të gjitha regjistrimet audio nga monitorimi dhe mund të merren ndëshkime disiplinore. Pra, edhe pse janë struktura të pavarura, përsëri ekzistojnë disa ndëshkime disiplinore.

**Arben Rakipi**– Kjo është një çështje që, gjithashtu, duhet parë në kompleksitet me analizën që ne kemi paraqitur në fillim të procesit. Ne dhe specialistët kemi konstatuar se centralizimi i fortë i prokurorisë është i dëmshëm, ka qenë një mendim unik i të gjithë trupës së prokurorëve dhe gjyqtarëve. Me aq sa kemi konstatuar, takuar dhe biseduar, nuk ka pasur asnjë prokuror ose gjyqtar që mendonte të kundërtën. Për rrjedhojë kemi propozuar zgjidhjen që prokurori i çështjes është i pavarur, sepse nuk mund të zgjidhnim variant të ndryshëm, ose të

linim variantin që është sot në fuqi. Po ashtu, kemi parashikuar disa mekanizma kontrolli për prokurorin e çështjes, në mënyrë që ai të jetë aktiv dhe, nëse eventualisht nuk është i tillë, prokurori titullar ka të drejtë të ndërhyjë për ta çuar procedimin përpara. Kjo është zgjidhja e parë.

E dyta, procedura parashikon një rol më të fortë të gjykatës në kontrollin e hetimit paraprak dhe pas kësaj është rritur jo vetëm kontrolli gjyqësor, por edhe përgjegjësia individuale e prokurorit të çështjes nëpërmjet elementeve të tjera që përmban ligji “Për prokurorinë”, siç është përgjegjësia disiplinore për dështimin, përgjegjësia civile për dëmet e kështu me radhë.

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit!

Keni pyetje të tjera?

*(Ndërhyrje pa mikrofon).*

**Vexhi Mucmata** – Unë e bëra pyetjen, por nuk mora përgjigjen e duhur. Morëm disa shpjegime të përgjithshme që nuk kanë lidhje fare me ligjin. Ligji thotë në mënyrë të plotë dhe të qartë se prokurori i Prokurorisë së Posaçme është i pavarur edhe nga vetë drejtuesi i prokurorisë, që do të thotë se në veprimtarinë hetimore dhe operacionale, nuk po flas për vendimmarrjen, është i pakontrollueshëm. Kjo, për mendimin tim, lë shteg për abuzimin. Nuk them që prokurori të mos jetë i pavarur, por duhet të jetë i kontrollueshëm, sepse praktika e deritanishme ka provuar se mungesa e kontrollit ka qenë pikërisht shkak kryesor i problematikave që janë krijuar nga hetimet e veprave penale nga prokuroria dhe nga Policia Gjyqësore, pra absolutisht nga mungesa e kontrollit. Prokurori edhe sot që flasim është i pavarur, e keni në procedurë. Çështja është te mungesa e kontrollit dhe, në rast se do të mungojë ky element, për mendimin tim, do të krijohen probleme në praktikë, probleme abuzimi, probleme arbitrariteti, prandaj kjo duhet parë si problem kryesor dhe kontrolli duhet të zgjidhet me ligj. Asnjë njeri nuk është i pagabueshëm dhe i pandikueshëm, aq më tepër në kushtet dhe në realitetin e vendit tonë. Shpjegimet për pyetjet duhet të jenë më konkrete, t’i përmbahen kornizës ligjore dhe të mos i kalojmë kaq lehtë, sepse pasojat do të jenë më të rënda nesër.

**Fatmir Xhafaj** – Ju lutem, mbylleni mikrofonin!

Zoti Rakipi, doni të bëni një koment?

**Arben Rakipi** – Për atë që thashë, unë u përpoqa të jem brenda kornizës ligjore dhe, kur thashë se prokurori duhet të jetë i pavarur, kam parasysh të gjithë rrethin e elementeve procedurale që përmban termi “pavarësi”. Sot prokurori nuk është i pavarur. E them këtë jo

vetëm për polemikë, por thjesht për të bërë dallimin. Prokurori nuk është i pavarur. Prokurori supozohet “të jetë i pavarur vetëm në seancë gjyqësore” - thotë ligji dhe kjo pavarësi është cenuar nga tendenca e praktikës kohë pas kohe, derisa kemi arritur në një defekt shumë të madh të sistemit. Kur them që prokurori është i pavarur, kam parasysh pikërisht ndryshimin e sistemit dhe kjo ka qenë një nevojë e të gjithëve, mjafton që të thuash se prokurori është i pavarur dhe nënkupton të tërë mënyrën se si ai punon. Por frika që edhe ne e kemi pasur këtë, për të mos u lënë shteg atyre të metave dhe dobësive që përmendi deputeti Muçmataj, kanë bërë që ne të japim disa elemente garancie që prokurori titullar të ndërhyjë në hetimet e zhvilluara nga prokurori i çështjes dhe ka një grup dispozitash, të cilat e bëjnë të mundur këtë lloj kontrolli. Nëse është e domosdoshme, unë mund t’i përmend të gjitha dispozitat, por duhet të shohim edhe ligjin “Për prokurorinë”, i cili ka disa elemente më tepër në këtë pikëpamje. E para.

E dyta, nëse do të flasim për abuzim, kjo është një çështje dhe nuk e di përse kalohet probabiliteti që edhe titullari të jetë i tillë, por një nga arsyet thelbësore që ka çuar në këtë zgjidhje është pikërisht fakti që çështja të zgjidhet nga ai duhet të ketë përgjegjësi për zgjidhjen. Praktika e sotme na tregon se titullarët nuk kanë përgjegjësi për zgjidhjet, pavarësisht se kanë atributin e madh që të japin urdhra të pashkruara dhe të vendosin ata, ndërkohë që përgjegjësia i ngel prokurorit të çështjes dhe ne me këtë zgjidhje kemi bërë të kundërtën, domethënë kemi evituar mundësinë që titullari të ndërhyjë pa të drejtë, të jetë jashtë perdes të mos ketë përgjegjësi dhe përgjegjësia t’i takojë atij që merr vendimin, që është formalisht vendimmarrësi. Kjo është zgjidhja dhe nuk është çështje thjesht e këtij ligji, por është çështje e tërë sistemit. E para në procedurë penale dhe e dyta pastaj në këto dy ligjet përkatëse, pra kemi ndjekur të njëjtën linjë në çështjet në fjalë.

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit!

Zoti Smibert.

**Jon Smibert** – (*Flet anglisht*) Neni 15, paragrafi 3, prokurorët e Prokurorisë së Posaçme hetojnë dhe ndjekin penalisht prokurorë të tjerë të Prokurorisë së Posaçme apo gjyqtarë të gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, nëse ka prova se prokurori apo gjykatësi është i korruptuar, mbështet një organizatë kriminale apo ka kryer një tjetër veprë penale. Në nenin 54, i cili flet për mbikqyrjen e vazhdueshme të telekomunikimeve dhe në paragrafin 3, nëse nga vëzhgimi i vazhdueshëm del informacion që mbështet një dyshim të arsyeshëm për veprimtari kriminale, ia raportojnë atë dyshim të arsyeshëm një prokurori çfarëdo të Prokurorisë

së Posaçme i cili nuk është i përfshirë në atë veprimtari. E njëjta gjë ndodh në nenin 55, në lidhje me llogaritë financiare. Llogaritë financiare nga burime të pazakonshme ose kriminale apo ekzistenca e llogarive financiare të cilat nuk janë të deklaruar, oficeri përgjegjës duhet ta raportojë në Prokurorinë e Posaçme, e cila nuk është përfshirë. Neni 58 flet për raportimin e informacionit dhe provave të një prokurori jo të përfshirë në Prokurorinë e Posaçme. Krijojnë detyrime dhe mundësi ligjore për ndjekje penale. Në kuadrin ligjor, përgjegjësia për shkelje disiplinore apo mosveprim parashikohet në ligjin e prokurorisë dhe statusit.

**Korajlka Bumci** – *(Flet anglisht)* Nëse i referohemi nenit 41 dhe 49 në ligjin për “Organizimin dhe funksionimin e prokurorisë” përmenden udhëzimet kur një Prokuror i Posaçëm mbikqyr rastin. Në nenin 51 të ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë” parashikohet se në raste të tilla rasti mund ti hiqet prokurorit. Ne i kemi të gjitha udhëzimet e përgjithshme. Struktura e këtij neni është i hartuar në bazë të rekomandimeve të Komisionit të Venecias.

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit!

A ka pyetje të tjera?

Po, zoti Manja.

**Ulsi Manja** – Ta ndajmë edhe një herë si merak të fundit lidhur me abuzimin, momentin e fillimit të ndjekjes penale me momentin e hetimeve të mëtejshme dhe të mënyrës së përfundimit të çështjes. Unë e kuptoj që ligji lidhur me vendimmarrjen e hetimit është kujdesur të ketë mekanizma kontrolli, ku i referohet mbledhjes së përgjithshme të prokurorëve të posaçëm dhe mbledhja e përgjithshme ka marrë attribute vendimmarrjeje lidhur me mënyrën e përfundimit të çështjes, sidomos për pushimin e çështjes dhe të hetimeve. Me aq sa unë kuptova, i gjithë shqetësimi dhe pyetja e kolegut tim Muçmataj, lidhet me momentin e fillimit të ndjekjes penale. Sa të mbrojtur do të jenë zyrtarët e lartë, në kuptim të nenit 132/2 të Kushtetutës ndaj fillimeve të ndjekjes penale për shkak të kësaj pavarësie, po flas për fillime ndjekjesh penale me tendencë të caktuara ndaj kësaj pavarësie që do të ketë kjo strukturë. Shqetësimi ishte te fillimi i ndjekjes penale ndaj një zyrtari të caktuara, ky ishte merak i abuzimit me këtë lloj pavarësie që kanë prokurorët e prokurorisë së posaçme, sepse për mënyrën e vazhdimit të hetimeve dhe për mënyrën e përfundimit ligji është kujdesur. Pra, a ka mekanizma garancie në këtë drejtim?

**Fatmir Xhafaj** – Po, zoti Rakipi.

**Arben Rakipi** – Mbase kjo pyetje është shumë hipotetike, por po përsëris edhe një gjë tjetër. Kjo frikë për mua është një 1/10 e mundësive që kjo mund të ndodhë në eventualitetin që titullari është një titullar i fortë si sot. Unë nuk shoh asnjë ndryshim pse nuk duhet të kemi frikë nga ky titullar. Kjo do të thotë se nga një titullar që ka gjithçka nën vete, të gjithë zyrtarët që ju thoni duhet të kenë frikë. Në qoftë se do të vazhdojë të jetë kjo frikë, ajo tani do të shtrihet për 10 persona brenda të cilëve mundë ketë edhe nga ata për të cilët ne nuk kemi pse të kemi frikë. Kështu që unë them se sistemi që kemi zgjedhur është garanci për ta evituar në maksimum atë. Praktika dhe historia tregojnë se një individ është më shumë i mundshëm për t'u manipuluar sesa dhjetë, prandaj sipas mendimit tim ne duhet ta përkrahim sistemin, sepse pikërisht ai se na ka çuar më larg abuzimit dhe nuk shoh zgjidhje më të mirë sesa kjo. Pastaj çështjes që do të fillojnë hetimet me të drejtë apo me pa të drejtë në pikëpamjen e procedurës dhe të ndjekjes penale nuk i jap ndonjë rëndësi të posaçme, pasi rëndësi të posaçme ka fakti i vendimit nëse prokurori është i përgjegjshëm dhe i drejtë kur merr vendim ose jo, ky është thelbi i procedurës dhe i asaj prej të cilës ne duhet të ruhem ose të tretët duhet të ruhen dhe për sa kohë që ne e kemi vendimin e prokurorit të kontrollueshëm si nga gjykata po ashtu edhe brenda sistemit, unë them se në letër kemi shkruar një sistem të përgjithshëm. Ndërsa për sa i takon praktikës nuk e di, ajo mund të na sjellë gjëra të paparashikuara për të cilat askush prej nesh nuk është në gjendje të japë një përgjigje sot.

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit!

A ka pyetje të tjera? Po, zonja Hysi.

**Vasilika Hysi** – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë e falënderoj grupin e punës për hartimin e këtij ligji, i cili është risi dhe është disi i vështirë. Është i vështirë, sepse ndryshon një koncept në një strukturë tashmë të konsoliduar prej vitesh jo vetëm tani, në periudhën e demokracisë, por edhe më parë. Unë kam disa pyetje, duke qenë se jam edhe relatore për ligjin “Për statusin e prokurorit”, si dhe për disa ligje të tjera që lidhen ngushtë me këtë ligj.

**Fatmir Xhafaj** – Ju lutem, mund t’ju ndërpres!

Ju lutem, jo pyetje që janë të karakterit nën për nën.

**Vasilika Hysi** – Jo.

**Fatmir Xhafaj** – Ju kërkohet ndjesë.

**Vasilika Hysi** – Do të rezervoj pyetje pastaj edhe për diskutimin nen për nen, nga të cilat kam shumë.

Pyetja e parë ka të bëjë me strukturën e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar: A mundemi të themi se cila është struktura? E bëj këtë pyetje, sepse diku nëpër ligj ju thoni që nuk ekzistojnë prokurori të veçanta për Gjykatën e Shkallës së Parë dhe Gjykatën e Apelit, por ka prokurorë të posaçëm. Pra, mund të kemi një strukturë, kemi gjykata të posaçme, por prokurorë të veçantë për Gjykatën e Apelit dhe Gjykatën e Shkallës së Parë nuk ka. Në ç'pozicion qëndron Byroja Kombëtare e Hetimit? Pyetja e parë.

Pyetja e dytë ka të bëjë me kompetencat parësore dhe dytësore të gjykatave. Ju thoni në ligj që gjykatat e posaçme që krijohen kanë kompetenca parësore të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale, megjithatë ato mund të marrin edhe çështje të tjera që mund të kenë lidhje. Cilat quani kompetenca dytësore? E bëj këtë pyetje, sepse ne kur kemi diskutuar Kushtetutën, kemi thënë që këto gjykata janë përgjegjëse edhe për hetimin e akuzave për funksionarët e lartë dhe nga ana tjetër këtu thuhet që nëse nuk fillon hetimi dhe ngrihet akuzë për një funksionar të lartë çështja vazhdon në juridiksionin e kësaj gjykate. Për çfarë çështjesh e keni fjalën?

Pyetja tjetër ka të bëjë me një sërë ligjesh që duhet të ndryshojnë. Nuk e di nëse grupi i punës ka përgatitur një listë të ligjeve ku do të ndërhyhet...

**Fatmir Xhafaj** – Po.

**Vasilika Hysi** - ... sepse është shumë e domosdoshme për të parë, pasi këtu me aq sa unë shikoj ndryshon ligji për mbrojtjen e dëshmitarit, për viktimat, ligji për përgjimet, ligji antimafia që i japim rëndësi. Pyetja tjetër ka të bëjë pikërisht me raportet e Byrosë Kombëtare të Hetimit me Policinë e Shtetit, pyetje që e ngritën edhe dy kolegët. Nga përgjigjet që u dhanë deri tani, përsëri nuk jam shumë e qartë se në çfarë raporti do të jetë Byroja Kombëtare e Hetimit me Policinë e Shtetit. Nga leximi që bëj në ligj shoh që Policia e Shtetit ka kompetenca të shpallë konkurs për të bërë rekrutime ose nëpër ligj ju thoni shpesh që Byroja Kombëtare funksionon me shërbimet e tjera, punonjësit do të vijnë nga këto shërbime e të tjera. Ky lloj komunikimi është vetëm në fazën e parë kur do të ngrihet Byroja Kombëtare e Hetimit, pra kur do të fillojë procesi i rekrutimit apo do të ketë një komunikim të vazhdueshëm? Ndoshta nuk e kemi kuptuar qartë në ligj, por mua më duket sikur ky ligj do të krijojë probleme në praktikë, do të ketë një përplasje permanente midis Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe Policisë së Shtetit, dhe unë këtë përshtypje e krijoj të paktën nga mënyra se si është shkruar shqip ligji, nuk e di se si është në origjinën dhe



variantin e tij, pasi shoh që hera-herës detyra u lihen edhe punonjësve të Policisë të Shtetit ku thuhet: “Punonjës të këtyre organeve të posaçme lënë detyra, ngarkojnë Policinë e Shtetit të kryejë veprime të caktuara”. Nuk e di nëse a e kam kuptuar qartë këtë apo jo?

Gjithashtu, kam një pyetje lidhur me seksionet dhe shërbimet. Seksioneve dhe shërbimeve u jepet akses në të gjitha databaset që ekzistojnë, me përjashtim të databaseve ku thuhet se informacioni është “sekret shtetëror”. Ky lloj akses do t’i jepet çdo punonjësi? Mua të paktën nga leximi i ligjit më del se kushdo që punon në këto struktura do të ketë akses, në të gjitha të dhënat e databaset që ekzistojnë dhe merakun këtu, unë e kuptoj si kolegun Muçmataj, ashtu edhe kolegun Ulsi, të cilët janë njohës më të mirë të prokurorisë se unë, pasi kanë punuar, kanë kontribuar për vite të tëra në drejtimin e prokurorive, mund të ketë pastaj shteg për abuzime ose për përdorim të informacionit, për fillimin e hetimit ose jo në mënyrë selektive.

Kam një pyetje lidhur me një risi që parashikohet në ligj, lidhur me detyrimet që ka Policia e Shtetit, neni 30. Policia e Shtetit ka një sërë detyrimesh për të raportuar ose kur ka informacione te Byroja Kombëtare e Hetimit dhe kjo është një pikë ku unë do të doja më shumë sqarime, për mënyrën se si duhet të komunikojnë këto dy institucioneve, pasi kjo mund të shërbejë si një bazë që në vend që të jetë një hetim efektiv, të kemi një ligj, i cili do të funksionojë për qëllimet që ka, i cili është i domosdoshëm të na e dëmtojë procesin.

Në ligj parashikohet poligrafi diçka që ne nuk e pranojmë, nuk e kemi pranuar për vite dhe nuk e pranojmë në praktikë. Ne kemi një parim që nuk lejohen të përdoren metoda, të cilat vënë në diskutim aspektet psikologjike, ne nuk pranojmë në Kodin e Procedurës Penale ekspertimet psikologjike e të tjera. Parashikimi i përdorimit të poligrafit është parashikuar që të ketë përmirësime në Kodin e Procedurës Penale te parimet e përgjithshme apo edhe te kapitujt ku flitet për ekspertizat? Të paktën me aq përvojë që kemi ne deri më sot, sepse gjithmonë kur kemi qenë me studentët e kemi kundërshtuar përdorimin e poligrafit.

Gjithashtu, kam një pyetje lidhur me verifikimin e pasurive dhe përgjimet e komunikimeve. Nuk e di nëse e kam kuptuar qartë ose jo, por unë shoh se midis konceptit se kush është anëtar i afërt i familjes, që është dhënë të përkufizimet, në vazhdim të ligjit e shoh të ndryshuar këtë lloj koncepti. Pra, fillimisht rrethi i anëtarëve të familjes është përcaktuar më i ngushtë dhe më pas në një sërë dispozitash, qoftë te 48 apo te 52 është zgjeruar më shumë dhe vende-vende themi që konceptimi i anëtarit të familjes do të jetë ai që përdoret në ligjin “Për kontrollin e deklarimin e pasurive dhe konfliktin e interesave”, cilido të jetë. E bëj këtë pyetje jo

sepse është nen për nen, por, sepse është parimore, pra deri ku do të shkojë qoftë edhe një punonjës i thjeshtë i Byrosë Kombëtare të Hetimit, i prokurorisë, i gjykatës, që do të deklarojë, siç e keni thënë ju, kushërinj të parë, të dytë, keni thënë ju, të tretë, vjehrrin, vjehrrën, dajat, xhajat, hallat, tezet e të tjerë, ndërkohë që vende-vende ju thoni që do t'i nënshtrohet ligjit të kontrollit të deklarimit të pasurive dhe koncepteve që përdor ky ligj, por edhe te përkufizimi, gjithashtu.

Dua të dëgjoj pak më shumë raportet midis Këshillit të Prokurorëve, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe prokurorëve të posaçëm. Lidhur me buxhetin, ju thoni që prokuroria e posaçme aplikon direkt, ndërsa byroja duhet të shkojë te prokurori i posaçëm, por ne kemi disa ligje për buxhetin që nuk janë pjesë e paketës dhe në qoftë se e kam kuptuar qartë a mundet prokuroria e posaçme të aplikojë direkt zërat e buxhetit pa kaluar te Këshilli i Lartë i Prokurorisë?

E fundit, kam një pyetje lidhur me marrëdhëniet e Byrosë Kombëtare të Hetimit me të gjitha shërbimet e tjera, pasi në ligj thuhet që të gjitha shërbimet e tjera duhet të jenë në funksion, të gjitha institucionet duhet të japin shërbime e të tjera. Jam dakord që duhet të ketë një bashkëpunim, por edhe institucionet e tjera funksionojnë me ligje organike, ligje të cilat janë me 3/5-t ose janë ligje specifike. Si e keni menduar që me këtë ligj t'i detyroni institucionet e tjera për të përmbushur shumë detyrime, të cilat aktualisht nuk i kanë.

Këto ishin disa nga pyetjet që unë kisha, duke rezervuar më pas të drejtën në diskutimin nen për nen për të qartësuar çështje të tjera. Faleminderit!

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit!

Ne do të fillojmë me përgjigjet.

Zoti Smibert e ka fjalën fillimisht.

**Jon Smibert** – *(flet anglisht)* Unë do të përpiqem t'u përgjigjem të gjitha pyetjeve. Pyetja e parë kishte të bënte me faktin që nëse prokuroria e posaçme ka përgjegjësi parësore apo dytësore, pra nëse ajo ka përgjegjësinë për të argumentuar në shkallën e parë dhe të dytë. Pse qëndron kjo? Në shumë raste, kur ka pasur një zyrë të suksesshme të prokurorisë së posaçme apo një zyrë të posaçme prokurorie, e cila merret me çështje mjaft të rëndësishme, atëherë një prokuror nuk do të jetë vetëm përgjegjës për shkallën e parë, por do të jetë përgjegjës edhe për të shkuar në instancën apo nivelin e dytë për arsye të ndryshme. Së pari, sepse ti po ndan përgjegjësinë ndërmjet një prokurori të Apelit dhe një prokurori të Shkallës së Parë dhe në këtë

pikë këtu mund të kemi një person të dytë, i cili po argumenton për çështjen dhe në këtë mënyrë hiqet edhe përgjegjësia apo e ndan përgjegjësinë për çështjen.

Arsyeja e dytë është se nëse ju do të fillonit nivelin e parë dhe nivelin e dytë brenda prokurorisë së posaçme, atëherë ju do të kishit edhe kryeprokuror të nivelit të parë dhe të nivelit të dytë, i cili në atë pikë do të dilte se kush është përgjegjës për këtë çështje në veçanti. Pra, sipas mendimit tim dhe sipas mendimit të Korës, e cila nguli këmbë për këtë gjë, është se në këtë rast do të ishte mirë që të kishim vetëm një nivel që t'u japë përgjigje të dy niveleve si atij të shkallës së parë dhe të shkallës së dytë, mbase ta çojë çështjen edhe në Gjykatën e Lartë. Sipas mendimit tim, kjo gjë ka kuptim, sepse ju po përpiqeni t'i keni këta prokurorë, të cilët shpresojmë që do të jenë prokurorët më të mirë për të trajtuar çështjet më të vështira dhe ata do të jenë prokurorë që do të bëjnë edhe argumentimin e këtyre çështjeve në mënyrën e tyre më të mirë, veçanërisht brenda strukturës që ne krijuam.

Pyetja e dytë që ju bëtë kishte të bënte me kompetencat parësore dhe dytësore dhe në mënyrë specifike ju përqendroheshit te zyrtarët e lartë, edhe pse kjo nuk do të ishte mirë në këtë mënyrë. Nëse do të shihni në nenin 75.a, aty përfshihen të gjithë veprat penale që kryhen nga personat dhe aty specifikohen të gjitha krimet. Pra, neni 75 përfshin edhe çfarëdo veprash penale që kryhet nga persona të veçantë. Për sa u takon kompetencave dytësore, kjo nuk do të thotë që unë mund të sjell një çështje si një prokuror i veçantë brenda zyrës së prokurorisë të posaçme vetëm duke u bazuar në kompetencën dytësore, ti duhet të kesh kompetencën parësore. Pra, duhet të jetë një çështje korrupsioni dhe mbase kjo çështje korrupsioni ka brenda saj edhe pastrimin e parave apo ka edhe diçka që lidhet edhe me dëshmitarin dhe ky ishte qëllimi i kësaj.

Pyetja tjetër që ju bëtë kishte të bënte me ligjet e tjera që ne kemi dhe unë besoj se kjo është diçka që ne ia kemi paraqitur komisionit dhe mund ta bëjmë këtë përsëri. Në lidhje me pyetjet e tjera që ju ngritët për sa i takon marrëdhënies midis BKH-së dhe Policisë së Shtetit, çfarë do të thotë kjo në mënyrë reale, sepse unë nuk mund të flas për vizionin? Vizioni është që zyra e prokurorisë së posaçme do të ketë nevojë për persona, të cilët do të trajtojnë çështje dhe hetime të ndjeshme ndryshe nga BKH-ja. Por, pavarësisht se çfarë bëjnë ata, BKH-ja do të jetë vetëm një organ i vogël me shumë kapacitete dhe ne jemi të gatshëm për t'i trajtuar dhe për t'u ofruar pajisje, por ata nuk mund të jenë RENEJA, ajo nuk mund t'i ketë të gjithë informatorët e ndryshëm, për shembull, që mund të jetë në botën e krimin të organizuar apo në botën e drogës. Sigurisht, ajo duhet të ruajë një marrëdhënie me Policinë e Shtetit dhe disa çështje mund të

bëhen vetëm në sajë të bashkëpunimit me policinë, sepse kjo nuk mund t'i ketë të gjithë informatorët e saj. Pra, ju mund ta keni të barasvlershme me FBI-në e Amerikës, po në këtë mënyrë do t'ju duhej një organ më i madh dhe për këtë arsye është e nevojshme edhe marrëdhënia me Policinë e Shtetit dhe përsëri FBI-ja do të vijë në ndihmë për ato çështje që janë më të ndjeshme, më delikate dhe do të jetë e nevojshme që të jetë. Pra, ky është ai vizioni i përgjithshëm për sa u përket marrëdhënies së BKI-së, ndërsa për pjesën tjetër në lidhje me teknikalitetet duhet të futemi më në thellësi.

Pyetja tjetër ka të bëjë me aksesin në bazën e të dhënave dhe të informacionit që ndodhet brenda sistemit. Kjo është diçka, e cila mbështetet mbi përvojën e vende të tjera. Ata kanë një akses të menjëhershëm ndaj informacionit (Kora mund të flasë më shumë për këtë saponë të mbaroj listën e përgjigjeve të mia, sepse nuk dua të harroj diçka), ndoshta Kora mund ta thotë në mënyrë të saktë se si kjo ndodh në lidhje me aksesin ndaj informacionit në Kroaci. Mendoj se ju këtu mund të keni këtu një frikë të veçantë se dikush mund të ketë akses ndaj gjithë këtyre të dhënave, kjo gjë ka ndodhur në të kaluarën dhe mund të ndodhë edhe në të ardhmen, prandaj informacioni do të kalojë te shtypi.

Pra, ne kemi thënë se është një zyrë, e cila do të merret vetëm me shtypin dhe askush nuk duhet ta ketë këtë lidhje me shtypin dhe kjo është normale. Në shumë vende të tjera prokurorët nuk duhet të flasin me shtypin, por vetëm në rrethana të veçanta ai mund të flasë me shtypin, por jo për çfarëdolloj arsyeje. Për këtë ne duam të mbajmë pikërisht këtë lloj tradite.

Pyetja tjetër kishte të bënte me poligrafën, detyrimin për të pasur një të tillë. Një nga arsyet dhe mënyra se si është hartuar fillimisht, edhe pse kjo ka ndryshuar më pas me ndryshimet që janë bërë, kjo ka qëndruar siç ka qenë në fillim për shkak të të dyja arsyeve.

Së pari, për të qenë paralele në funksionet e saj ashtu sikundër është edhe FBI-ja.

Së dyti, ka kërkesa ndaj oficerëve të policisë në institucione të tjera, nuk e di se si ato quheshin në Kroaci këta persona. Në Amerikë ne kemi marrë ndihmë për këtë gjë, nëse provat që merren nga poligrafia janë prova, por në fakt nuk janë prova, por disa mjete, të cilat gjatë intervistimit apo marrjes në pyetje, unë mund të nxjerr që ti nuk je duke thënë të vërtetën, por kjo nuk përdoret si provë. Pra, është thjesht një mënyrë për të kontrolluar njerëzit nëse po thonë të vërtetën apo jo.

**Rainer Deville** – *(flet anglisht)* Është kundër standardeve europiane.

**Jon Smibert** –(flet anglisht) Për sa i përket verifikimit të pasurive dhe monitorimit të telekomunikacionit me anë të kësaj pyetje ju thatë se përse anëtarët e afërm të familjes japin përkufizime të ndryshme, ku përfshihen më shumë njerëz në disa vende të tjera. Mendoj, se arsyeja, të cilën ti do ta gjesh, është se disa persona mund t'i nënshtrohen monitorimit, apo personat, të cilëve do t'u monitorohen edhe veprimet e tyre, janë gjithmonë pjesëtarët më të afërm të familjes.

Ndërsa për sa i përket deklarimit, ti mund të deklarosh më shumë persona gjatë procesit të kontrollit, madje do të ishte më e rëndësishme që edhe kushërinjtë e tu madje, edhe kushëririn e dytë, nëse ai është i kërkuar në Itali, le të themi, pra, në këtë mënyrë do të japin një ide apo një panoramë më të qartë se kush je ti si person.

Ndërsa për sa i përket marrëdhënies ndërmjet Këshillit të Lartë të Prokurorisë në lidhje me buxhetin, një tjetër arsye e kësaj, duke u bazuar në përvojat e shteteve të tjera, është se buxheti duhet të jetë i pavarur, sepse vetëm në këtë mënyrë ti nuk mund të kesh kontroll ndaj një institucioni. Nëse do të kesh kontroll ndaj një institucioni, ai bëhet menjëherë nëpërmjet një reduktimit të buxhetit. Për këtë arsye ideja është që ata mund të kenë modestinë t'ia paraqesin buxhetin e tyre ministrit të Financave, me qëllim që të përfshihen brenda buxhetit të përgjithshëm të shtetit.

Pyetja juaj e fundit kishte të bënte me marrëdhëniet ndërmjet mekanizmave të raportimit, BKI-së dhe agjencive të tjera, të cilat i kanë në ligjet e tyre organike, kjo është një pyetje e sinqertë dhe do të ishte më mirë që të lidhej me shqyrtimin nen për nen. Meqenëse ju bëtë pyetje në lidhje me disa dispozita, atëherë mund ta shikojmë këtë, nëse ka ndonjë konflikt me ligjet organike, por mendoj se pjesa më e madhe e detyrimeve raportuese mund të kenë edhe veprime të tjera, të cilat ju mendoni se janë në kundërshtim me ligjin organik. Ne mund të flasim për këtë, por do të na duhet të flasim shumë nëse do të merremi me të gjitha këto, sepse deri tani u jam përgjigjur 9 pyetjeve. Pra, kjo ishte e gjitha.

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit!

**Jon Smibert** - (flet anglisht) Do të doja të shtoja një gjë. Ju pyetët fillimisht në lidhjen e marrëdhënies me ligjet dhe prokurorinë. Kjo marrëdhënie përcaktohet së bashku me ligjin “Për prokurorinë”. Siç e thashë në fillim, duhet të shikoni ligjin “Për SPAK-un” dhe ligjin “Për prokurorinë”. Pra, duhet t'i referoheni këtyre dy ligjeve.

Buxheti i veçantë, gjithashtu, përcaktohet në ligjin “Për prokurorinë”, ndërsa këtu thjesht përsëritet. Mendoj se çështja e buxhetit, ashtu siç e përmendi dhe Xhoni, është gjëja më e rëndësishme dhe mendojmë se, ashtu siç ndodhi me Prokurorin e Përgjithshëm në Kroaci, siç e përmendi ai, është thënë më herët edhe nga prokurorët në Kroaci, kjo është një çështje me problematikë të veçantë.

Mendoj se do të flasim më shumë në detaje kur të kalojmë në diskutimin nen pas neni. Mendoj se u dha pak a shumë një përgjigje e përgjithshme.

Ndoshta zoti Rakipi ka për të thënë diçka.

**Fatmir Xhafaj** – U konsumuan pyetjet e zonjës Hysi. Dakord me përgjigjet e dhëna.

A ka pyetje të tjera? Nuk ka pyetje të tjera.

Kam edhe unë diçka. Nuk do të bëj pyetje, që t’i jap mundësinë zotit Rajner të mos shqetësohet më tej për orarin, por në formën e konstatimeve, dhe të sugjerimeve do të jap çështjet që do të duhet të trajtojë relatori, sipas pikëpamjes sime gjithmonë, në relativimin që do të bëjë në seancën e ardhshme dhe, njëkohësisht, për t’u pasur në vëmendje prej tij dhe të gjithëve ne gjatë diskutimit nen për nen.

Para se të them tre-katër çështjet, që kam menduar t’i nënvizoj, i bashkohem vlerësimit të kolegëve që ky është një ligj i rëndësishëm, është një nga risitë themelore ose pritshmëritë themelore të reformës në drejtësi; është një prej atyre pritshmërive të larta që ka shoqëria shqiptare dhe, në mënyrë të veçantë, qytetarët shqiptarë ndaj kësaj reforme.

Është bërë një punë shumë e vlerësuar nga ekspertët e nivelit të lartë, pa dyshim, në mënyrë të veçantë nga zoti Smibert, për shkak të përvojës që ka, dhe rolit që ka pasur në proceset e mëparshme. Unë dua ta falënderoj atë përzemësisht për kontributin e dhënë! Gjithashtu, dua të vlerësoj punën e zonjës Bumçi në karrierën e saj dhe përvojën që ka Kroacia në këtë fushë. Do të doja të vlerësoja punën e zotit Rakipi, zotit Hoxha dhe të gjithë ekspertëve të nivelit të lartë, që janë pjesë e sistemit të drejtësisë penale, ose më saktë, që kanë kontribuar në gjithë këtë proces, duke mbajtur në konsideratë edhe praktikën, edhe problematikën që vendi ka shfaqur në vite në këtë fushë dhe nevojën që kemi për të dhënë disa zgjidhje, të cilat të jenë të përputhshme me kuadrin ligjor dhe me praktikën e punës së institucioneve ligjzbatuese në fushat përkatëse.

E shoh këtu me shumë interes faktin që në *footnot-et* e paraqitura janë marrë në konsideratë shumë opinione të Ministrisë së Drejtësisë, për shkak të rolit që kjo ministri ka në

kodifikimin e legjislacionit dhe në mënyrë të veçantë të faktin që është duke u punuar edhe për Kodin e Procedurës Penale. Këto i shoh të reflektuara në mënyrë të konsiderueshme në këtë projekt. Gjithashtu, edhe shumë komente të bëra nga ekspertët gjatë diskutimeve *things teng* që e kanë përmirësuar projektin.

Por, gjithsesi, ka disa çështje që duhet të kenë më shumë vëmendje. Unë jam shumë i bindur, nga përvoja ime modeste në jetë, bëj pjesë tek ata që bashkë me zonzjën Aurela mendojmë njësoj, që nuk ka ligj perfekt dhe nuk ka si të jetë edhe ky perfekt. Ligji sa më i mirë të jetë, aq më mirë do të zbatohet dhe aq më efekte pozitive do të ketë. Në funksion të kësaj duhen kuptuar edhe shqetësimet e kolegëve, edhe ato që do të trajtohen në vazhdim.

Më konkretisht, çështjet që unë do të dëshiroja të sillja në vëmendjen e relatorit, por edhe të kolegëve dhe të grupit të punës, janë:

Së pari, hartuesit janë kujdesur që t'i kushtojnë vëmendje të veçantë pavarësisë së institucionit të prokurorisë, pavarësisë reale të tij. Jam shumë dakord me zotin Rakipi që ajo sot nuk është. Ne po bëjmë një përpjekje të konsiderueshme, është një nga qëllimet kryesore të kësaj reforme, për t'i dhënë institucioneve të drejtësisë, në mënyrë të veçantë atyre të drejtësisë penale pavarësinë reale, funksionale, institucionale e të tjera.

Nga ana tjetër, ne duhet të vendosim një raport shumë të drejtë ndërmjet pavarësisë së domosdoshme dhe nevojës për përgjegjshmëri dhe llogaridhënie të këtyre institucioneve. Shqetësimi që ngrenë kolegët krijon përshtypjen se kjo pavarësi e fortë jo përherë shoqërohet me llogaridhënie të fortë dhe përgjegjshmëri të kontrolluar, jo thjesht dhe vetëm, nga pikëpamja e cilësive që do të kenë kandidatët, por nga pikëpamja e ushtrimit të profesioneve të tyre në proces. Këtu unë jam pak i preokopuar se si e kemi i dhënë zgjidhje një fenomeni që kemi sot, zoti Rakipi, pikërisht fenomenit të korporatizmit në sistem. Kjo pavarësi e fortë, e pa shoqëruar me disa elemente të forta të llogaridhënies dhe përgjegjshmërisë, a mund të krijojnë një koorparatë të re që mund të jetë e dëmshme në funksion të pavarësisë dhe besueshmërisë së institucionit të publiku? A ka vend këtu për t'i forcuar këto elemente përgjegjshmërie dhe llogaridhënie të këtyre njerëzve, përtej cilësive të përzgjedhjes së tyre, por në ushtrimin detyrës, sepse koorparatat nuk krijohen para se të emërohen, por në ushtrim e sipër për shkak të lidhjeve dhe mungesës së llogaridhënies?

Elementi i dytë që kam është se ky është një ligj i një natyre të veçantë, i natyrës procedurale dhe materiale. Jam dakord me atë që thanë kolegët. Ky ligj i ka të ndërthurur këto

elemente. Jam shumë dakord. Por shqetësimi im është sa kemi në një përputhje në mes të këtij ligji, për efekt të kësaj natyre specifike të tij, me Kodin e Procedurës Penale që është duke u përpunuar, me ligjin “Për Policinë Gjyqësore”, dhe me ligjin “Për Policinë e Shtetit”, siç thotë zonja Hysi, por në këndvështrimin tim nuk është e drejtpërdrejtë, në mënyrë që institute që janë tashmë të konsoliduara, të mos kenë zgjidhje të ndryshme? Kur të hyjmë nën për nën, unë shoh te Kodi i Procedurës Penale disa institute që janë të konsoliduara, të cilat kanë një devijim në shtjellimet e tyre, kështu që ose duhet të ruajmë të njëjtën gjuhë, absolutisht nuk ka asgjë të keqe, rishikimet duhet të ndjekin këtë ligj dhe kjo është normale, ose ky ligj vetë ka nevojë t’i reflektohet instituteve të së drejtës penale. Ky është një preukopim që kam.

Elementi i tretë, që lidhet edhe me çështjen e parë, ka të bëjë me elementin e dy dukurive që kemi pasur në hetim: atë që quhet shpeshherë dukuria e pingpongut, pra kalimin e përgjegjësisë nga njëri institucion tek tjetri, këtu druaj sa mund ta keni zgjidhur, pavarësisht se ne kemi vënë disa dispozita për bashkëpunimin; e dyta është çështja e terminologjisë shqiptare edhe kjo, “i fëmijës jetim” të përgjegjësia, sidomos në rrafshin e policive gjyqësore dhe bashkëpunimit ndërmjet tyre.

Elementi tjetër që doja të theksoja është që zoti Rakipi foli për një rol të rishikuar të gjykatës në hetimin paraprak, që në Kodin e Procedurës Penale jeni duke e parë me sa kuptoj unë. Personalisht mendoj, por këtu nuk jemi për të ndjekur mendimet personalet tonat, unë do ta mbështesja fort këtë gjë, kjo lidhet edhe me shqetësimin për të forcuar fort llogaridhënien dhe përgjegjshmërinë e prokurorisë në përgjithësi. Sa kohë që ne dobësojmë centralizimin dhe u japim më shumë autonomi dhe pavarësi prokurorëve të veçantë, edhe te prokurorët e juridiksionit të përgjithshëm, edhe tek ata me juridiksion të posaçëm, është shumë i rëndësishëm kontrolli i gjykatës mbi to. Në mënyrë të veçantë, ne kemi problem shumë të madh me çështjet e pezulluara dhe të pushuara. Ju keni gjetur një zgjidhje, mbledhjen e përgjithshme. Mbledhja e përgjithshme është një organ procedural? A mund të sillet si e tillë nga pikëpamja e procedurës, jo na pikëpamja institucionale se kjo është një çështje tjetër, pastaj? E kam ndeshur këtë edhe te ligji “Për prokurorinë”, por atje është i një natyre institucionale, ndërsa këtu shndërrohet në një instrument procedural. Kjo nuk është fort bindëse, ose më saktë ndoshta nuk është kjo zgjidhja. Qëllimi është shumë i mirë, për herë të parë e ndesh, mbase dhe gaboj, mbase nuk ka njohuritë e mjaftueshme në fushën e së drejtës penale, por për herë të parë e ndesh si zgjidhje këtë. Mund të



qëndrojë, por duhet parë, kështu si instrument procedural është e vështirë. Problemi që do të zgjidhë është shumë i drejtë.

Elementi tjetër që dua të shtoj, mbase nuk është shumë e rëndësishme kjo që po them, por duhet pasur në vëmendje një përputhshmëri e mirë ndërmjet ligjit “Për prokurorinë e posaçme” dhe ligjit “Për prokurorinë”, të paktën nga pikëpamja e disa funksioneve dhe disa termave. Nuk ka asnjë arsye sa kohë këto janë pjesë e drejtësisë penale, janë institucione të sistemit të drejtësisë penale, disa funksione disa terma që kryejnë, janë për shërbime të njëjta, për qëllime të njëjta, nuk kanë pse të kenë zgjidhje të ndryshme dhe emërtime të ndryshme, për shembull, ata përdorin sekretar i përgjithshëm, këtu përdoret kancelar. Një shtet, një drejtësi penale, një parlament, pse duhet t’i kemi të ndryshme? Nuk janë thelbësore, por edhe nga pikëpamja e rregullimit të disa strukturave, e kuptoj se zonja Bumçi nuk është dakord, por për të qenë bindës, po shkoj te buxheti. Hapni faqen në nenin 60. Alma më ndihmoi ta lexoja, por nuk më dha zgjidhje. Pra, në nenin 60 “Buxheti fillestar”, pasi të zgjidhet buxheti fillestar, për të cilin folët gjatë se buxheti është i rëndësishëm e të tjera. Çfarë do të bëhet me buxhetin në vijim? Si do të organizohet buxheti në vijim? Këta nuk është se do të punojnë, do të marrin një herë karburant te pitstop-i i parë dhe pastaj nuk do të kenë pitstop-e të tjera, ku do të ndalojnë të furnizohen. Çdo vit do të kenë buxhet. I keni dhënë një zgjidhje kur flisni për BKH-në, por nuk i keni dhënë zgjidhje asaj nga e cila derivon edhe buxheti i BKH-së.

Meqenëse jemi këtu te BKH-ja, nuk e kisha menduar se do ta shtroja tani, por e shtroj që sot, në Kushtetutë e përdorim me termin “Njësi e Posaçme Hetimore” këtu përdorim termin “Byroja Kombëtare e Hetimit”, mos duhet që te përkufizimet ta sqarojmë, në kuptim të këtij ligji se në Kushtetutë ne kemi thënë “Njësia e Posaçme Hetimore”, por e lëmë vetëm BKH, mbetet jetim termi “Njësie Posaçme Hetimore” dhe rrezikojnë që të shkojë nesër në Gjykatë Kushtetuese dhe të thuhet se kjo nuk është se ju e keni “Njësi të Posaçme Hetimore”.

Zonja Vorsi thotë se nuk e bën Gjykata Kushtetuese këtë, por ka bërë edhe gjëra të tjera, pse të mos e bëjnë dhe këtë.

Ky është pak a shumë rrethi i çështjeve. Unë nuk dua ndonjë përgjigje, sepse thashë nuk janë çështje janë më shumë për të nxitur relatorin gjatë përgatitjes së tij për paraqitjen e ligjit dhe, njëkohësisht, për shqyrtimin nen për nen, por edhe për të qenë të sqaruar për këndvështrimet që kemi, në funksion të përmirësimit të mëtejshëm të ligjit.

E theksoj, ligji i tërë është një risi, jo elemente të ligjit kanë risi; vetë ligji është një risi dhe puna që është bërë, absolutisht jam i bindur, ka qenë një punë shumë e vështirë për ta përshtatur me Kushtetutën e vendit, me opinionin final dhe opinionin e Komisionit të Venecias, me kuadrin ligjor që është në fuqi, me mentalitetin dhe praktikën që kemi këtu. Mua nuk më mbetet gjë tjetër veçse të them fjalët më të mira për ata që kanë nxjerrë nga duart këtë produkt që shpresoj t'i rezistojë kohës dhe të japë pritshmërinë që kanë të gjithë për këtë projektligj, por nevoja për ta përmirësuar, për ta bërë më eficient dhe rezultativ mbetet.

Faleminderit! E e mbylлим këtu, me mirëkuptimin e të gjithëve, në mënyrë që të vazhdojmë me projektligjin tjetër, që është pjesë e pikës së parë të rendit të ditës, projektligji “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Një tjetër projektligj risi në vetvete, një tjetër projektligj shumë i vështirë, për të cilin po i komplimentoj që tani të gjithë ata që kanë punuar me këtë projektligj pasi thjesht shkurt kanë bërë një punë të mrekullueshme, kanë dhënë një zgjidhje profesionale. Besoj se, nëse kjo reformë do të identifikohet ndonjëherë me suksesin, natyrisht, pa dyshim, krahas ligjit që sapo shqyrtoam, merita tjetër do t'i takojë këtij projektligji që do të prezantojmë tani dhe për ta bërë këtë gjë janë të pranishëm: Zoti Rainer Deville, shefi i misionit EURALIUS dhe njëkohësisht bashkëdrejtuesi i këtij grupi pune, që i ka kushtuar kohën më të madhe, edhe në konspiracion shpeshherë, këtij projektligji, por sa kohë që ka pasur të bëjë me Brukselin ka qenë i shpjeguar. Natyrisht, së bashku me zotin Deville, është edhe zoti Smibert, se po të ishte ndryshe, të mos ishin bashkë, do të çuditëshim të gjithë. Po kështu edhe zoti Smibert ka punuar dhe kontribuar për këtë projekt. Në krah të tyre është profesoresha e nderuar zonja Anastasi, që ka qenë bashkëdrejtuese e këtij grupi pune, për të na bërë një paraqitje të këtij projekti, i cili është fryt i punës së përbashkët të tyre, të të gjithë ekspertëve të nivelit të lartë, të Sekretariatit Teknik, që kanë shoqëruar hartimin e këtij projektligji, të konsultimeve, të thing teng-ut që ka shërbyer për ta ndihmuar këtë proces konsultimi publik që është bërë, natyrisht edhe të vetë rolit që kanë luajtur strukturat përgjegjëse të ligjit pranë Komisionit Europian, të cilat janë kujdesur që duke qenë një ligj delikat nga pikëpamja e çështjes së zgjidh dhe nga pikëpamja e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të jetë një ligj sa më i plotë. Kështu që kemi një kontribut të konsiderueshëm, por autorët kryesorë, ata që e kanë sjellë projektin deri këtu, janë para nesh. Mund të fillojnë me prezantimin e këtij projektligji. Kush do ta marrë fjalën? Po, zonja Anastasi.

**Aurela Anastasi** - Faleminderit, zoti kryetar!

Dy fjalë në lidhje me projektligjin, qëllimi i tij është rregullimi i posaçëm i rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve, prokurorëve dhe të gjitha subjekteve të tjera, që do të rivlerësohen në bazë të përcaktimeve të projektit të amendamentit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Në lidhje me këtë projektligji ka si objekt organizimin e strukturave, të cilat do të përbëjnë institucionet e rivlerësimit, përcaktimin e detyrave të tyre, mënyrën e funksionimit të tyre dhe, së dyti, rregullimin me dispozitat përkatëse, procedurale, që përcaktojnë parimet, standardet dhe metodologjinë me të cilën do të kryhet rivlerësimi. Sa u përket strukturave apo institucioneve të rivlerësimit, dua të theksoj faktin se kemi dy kategori institucionesh. Në vëmendje të veçantë projektligji ka pasur rregullimin e institucioneve të reja, të cilat krijohen posaçërisht për realizimin e kësaj detyre natyrisht edhe aktivizimin në mënyrë të përshtatshme, duke bashkëpunuar me institucionet e reja të rivlerësimit dhe të strukturave apo të institucioneve ekzistuese.

Do të them dy fjalë për metodologjinë. Metodatat tona janë përqendruar kryesisht në një deskstadi të përvojave të zhvilluara në vendet e tjera edhe pse këto nuk kanë qenë të shumta. Kemi mbajtur para sysh opinionin e ndërmjetëm dhe atë përfundimtar të Komisionit të Venecias për projektligjin tonë për ndryshimet kushtetuese, por njëkohësisht edhe opinionet e Komisionit të Venecias për vendet e tjera, duke vlerësuar ato çka Komisioni i Venecias i ka konsideruar si përvoja të pranueshme, por edhe ato çka i ka konsideruar si të pakalueshme.

Është bërë studimi i legjislacionit ekzistues, me qëllim krijimin e lidhjeve dhe referimeve të përshtatshme për realizimin e objektivave dhe të qëllimeve tona. Kemi referenca në mjaft ligje ekzistuese, sikurse janë parashikuar në ligj në mënyrë të detajuar, gjithashtu, kemi pasur parasysh studimin e përvojave të vlerësimit të vazhdueshëm sikurse është zhvilluar në Shqipëri, dhe kemi bërë kujdes që të ndërthurim atë çka kemi krijuar deri tani për të realizuar.

Natyrisht, e gjithë puna është kryer jo vetëm nga grupi i punës dhe nga misionet që ju, zoti kryetar, i përmendët, por në bashkëpunim të ngushtë me grupin thing teng, si dhe me grupet e interesit dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile, që kanë marrë pjesë në konsultimet e organizuarave me këtë rast.

Subjektet që do të rivlerësohen, në fakt, janë parashikuar në Kushtetutë. Unë doja të theksoja se ndahen në dy kategori të mëdha: subjekte që do të rivlerësojnë *ex officio*, sipas Kushtetutës, të gjithë gjyqtarët, përfshirë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, të gjithë prokurorët, përfshirë Prokurorin e Përgjithshëm, të gjithë inspektorët, përfshirë

kryeinspektorin pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, si dhe këshilltarët ligjorë të Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë dhe ndihmësit ligjorë të gjykatave Administrative dhe të Prokurorisë së Përgjithshme.

Kategoria e dytë janë subjektet që do të rivlerësohen me kërkesë të tyre. Në këtë kategori përfshihen: ish-gjyqtarët, ish - prokurorët, ish –këshilltarët ligjorë të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë.

Komponentët përbërës të rivlerësimit që rregullohen me kapituj dhe dispozita përkatëse në këtë projektligj janë: vlerësimi i pasurisë, që përfshin kontrollin e pasurive, ligjshmërinë e burimit të tyre, përmbushjen e detyrimeve financiare nga subjektet e rivlerësimit, nëpërmjet deklarimit nga vetë subjektet dhe nëpërmjet kontrollit të deklarimit; kontrolli i figurës, që përfshin identifikimin subjekteve që kanë kontakte të papërshtatshme, sipas përkufizimit dhe rregullimeve që janë bërë në ligj, nëpërmjet deklarimit të tyre vetë dhe verifikimit të asaj që kanë deklaruar vetë subjektet.

Së treti, do të ndalem te vlerësimi i aftësisë, ku përfshihet vlerësimi i aftësisë etike dhe profesionale. Metodat janë parashikuar shprehimisht në dispozita. Në ligj kemi parasysh sidomos kontrollin dhe verifikimin e dokumenteve ligjore, sipas përkufizimit të parashikuar në ligj, por edhe vlerësimet e vazhdueshme të krijuara.

Institucionet e pavarura që krijohen rishtazi me veprimtari të përkohshme, të posaçme vetëm për këtë ligj, me mbarimin e tyre dhe shfuqizimin e ligjit, ato mbarojnë së ekzistuari.

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, i quajtur komisioni, që shqyrton në shkallë të parë vlerësimin ose ribën rivlerësimin e gjyqtarëve, të prokurorëve dhe të subjekteve të tjerë, vendimet e tij ankimohen në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, ose shkurt Kolegji i Apelimit, strukturë e posaçme e krijuar pranë Gjykatës Kushtetuese, përmbush të gjitha standardet që përmbushin anëtarët e Gjykatës Kushtetuese; komisionerët publikë, të cilët mbrojnë interesat e publikut në të gjithë procesin dhe krijojnë kontradiktoritetin në proces, me qëllim realizimin e procesit të rregullt ligjor. Institucion mbështetës, operacioni ndërkombëtar i monitorimit.

Projektligji ka parashikuar, gjithashtu, institucionet ndihmëse për të gjitha veprimtaritë që kryhen në kuadrin e krijimit të institucioneve, funksionimit të tyre, bashkëpunimit me institucionet e tjera dhe kryerjen e rivlerësimit. Konkretisht për krijimin e institucioneve është e vërtetë që projektligji përcakton zgjedhjen e anëtarëve të tyre nga Kuvendi, me shumicën e përcaktuar, 2/3-at, por Kuvendi ndihmohet nga Avokati i Popullit, ILDKPI-ja, kurse formula e

zhbllokimit, në rast mosfunksionimi të zgjedhjes me shumicë të cilësuar, sikurse është parashikuar në projektligj, realizohet nën kontrollin ose nën kujdesin e Presidentit të Republikës si institucion dhe të gjitha këto mbështeten nga operacioni ndërkombëtar i monitorimit, që ka rol mbështetës, sikurse e thatë.

Organet ndihmëse për vlerësimin e pasurisë, natyrisht, janë ILDKPI-ja, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, Ministria e Drejtësisë, sidomos nëpërmjet zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme e të tjerë.

Organet ndihmëse të kontrollit të figurës. Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Kualifikuar ka rol shumë të rëndësishëm, por ajo bashkëpunon me Shërbimin Informativ Shtetëror dhe me Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm pranë Ministrisë së Brendshme, për këtë arsye ata krijojnë grupe pune me detyra të përcaktuara në projektligj.

Organet ndihmëse të aftësisë. Natyrisht këtu do t'i referohemi edhe ligjit "Për statusin e gjyqtarit dhe prokurorit", por sidoqoftë detyrime kanë: organet punëdhënëse; inspektorët, sipas përkufizimeve që kemi dhënë në ligj; Shkolla e Magjistraturës, që harton programe të posaçme e të tjerë. Natyrisht, këtu përfshihen edhe një sërë subjektesh jo vetëm publike, por edhe private, të cilat kanë detyrime të furnizojnë me të dhëna dhe të japin informacionin e kërkuar nga organet apo institucionet e rivlerësimit.

Parimet për krijimin dhe funksionimin e institucioneve. Këtu kemi parasysh: parimin e zgjedhjeve nga Kuvendi me votim; parashikimin e zhbllokimit në rast se kemi mosfunksionim të zgjedhjeve nga Kuvendi, nëpërmjet shortit; parimin e përzgjedhjes mbi bazën e meritës, të cilësisë profesionale dhe etike; parimin e zgjedhjes me procedura publike dhe transparente, që realizohet nga Kuvendi; parimin e bashkëpunimit me institucionet e tjera dhe të tjera si këto.

Për të siguruar një proces të drejtë, të rregullt dhe të sigurt është përcaktuar mirë statusi i anëtarëve të institucioneve, si dhe disa aspekte shumë të rëndësishme të strukturave ndihmëse, që rregullohen edhe me anekse përkatëse. Sidoqoftë, përcaktimi i mandatit apo i rasteve të përfundimit të tij para afatit; mbrojtja e posaçme e anëtarëve; mbrojtja e paanësisë dhe siguria nga konflikti i interesit; garantimi i konfidencialitetit; garantimi i besueshmërisë; garantimi i shpërblimit të anëtarëve të institucioneve, të gjitha këto ne i konsiderojmë një siguri, një garanci për statusin e anëtarëve të institucioneve.

Te pajtueshmëria me Kushtetutën dhe standardet ndërkombëtare, kemi parasysh që ky është një proces i posaçëm, por grupi i punës ka mbajtur në vëmendje të gjitha opinionet dhe

rekomandimet e Komisionit të Venecias për të realizuar një proces të rregullt ligjor. E kemi testuar këtë proces mbi bazën e nenit 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Kufizimi i të drejtës për informim bëhet vetëm për shkaqe të arsyeshme, në kushtet e veçanta të luftës kundër korrupsionit.

Përmbysja e barrës së provës nga institucionet tek i vlerësuarit garantohet nga standardi që kemi arritur ose që kanë arritur standardet ndërkombëtare në të drejtën administrative civile. Kjo është e garantuar në ligj që në asnjë rast nuk përdoret në proceset penale.

Kufizimi i të drejtës për një jetë private bëhet mbi bazën e deklaramentit të vullnetshëm nga ana e të vlerësuarve dhe nga ana e rrethit familjar sipas ligjit. Është garantuar e drejta për ankime dhe afate procedurale gati të zakonshme, edhe pse ligji kërkon shpejtësi dhe është i përkohshëm.

Lidhur me parimet e gjykimit, duhet të theksojmë se ka risi. Kështu, për shembull, ne jemi mësuar me parimin e zakonshëm procedural të gjykimit publik. Këtu kemi procedura publike dhe transparente, për mendimin tim, që detyrohen apo garantohen nëpërmjet monitorimit nga institucionet ndërkombëtare; nëpërmjet garantimit me dispozitë të posaçme për marrëdhëniet me mediet; nëpërmjet garantimit nga pjesëmarrja e publikut në denoncimin e fakteve, të cilit do t'i rezervohen edhe garanci të reja.

Parimi i kontradiktoritetit realizohet gjithashtu nëpërmjet komisionerëve publikë, edhe pse kemi vetëm një parim të rivlerësuarit. Raporti përfundimtar i rivlerësimit përcakton atë çfarë do të arrijmë në finale. Çfarë do të arrijmë në finale?

Së pari, të gjitha këto organe mund të vendosin konfirmimin në detyrë. Kjo realizohet vetëm në rast se 3 komponentët, në mënyrë kumulative, testohen në rregull me ligjin.

Së dyti, vendosin pezullimin nga detyra dhe vazhdimin e programit të trajnimit pranë Shkollës së Magjistraturës.

Së treti, vendosin shkarkimin nga detyra kur ka shkaqe të parashikuar nga rivlerësimi në bazë të këtij ligji. Faleminderit për vëmendjen!

**Fatmir Xhafaj** - Faleminderit, zonja Anastasi!

Po, zoti Vasili.

**Petrit Vasili** - Unë kam një konsideratë më tepër të karakterit parimor. Nuk e di nëse jemi në kohën e duhur sot për t'u marrë me këtë ligj, pasi e kemi thënë edhe publikisht që është

një çështje që ka mbetur pezull e një tentative për një marrëveshje politike dhe një tendencë e tillë reflektohet te projektligji.

Në këtë projektligj ne kemi propozimin, që është edhe zemra e problemit, për zgjedhjen e komisionerëve. Në ligj është bërë një propozim me 2/3-at, në një kohë që në ndryshimet kushtetuese që e kemi kaluar po vetë ne këtu, ndryshimet i kemi miratuar me 3/5-at.

Ne nuk mund të reflektojmë dhe të marrim një ligj, i cili ka brenda elementet e kompromisit politik, por që është në një proces të papërfunduar, ndërkohë që kemi ecur në një rrugë tjetër me Kushtetutën.

Ne e marrim ligjin në dorë duke qenë se jemi shumë të qartë. Nuk kemi kompromis politik, ndaj do të ecim në një rrugë të caktuar, që është rrugë e qartë.

Nuk i di fare formulat e kompromisit, sepse nuk jam familjar me to dhe as nuk dua të jem, por duhet të kërkonim një qasje tjetër. Sot nuk më duket momenti i përshtatshëm për t'u marrë me këtë ligj.

E thashë edhe një herë tjetër, vetëm fakti që edhe sikur ne sot të mbajmë një qëndrim në parim çfarëdo, dhe këtu kemi reflektime të një kompromisi politik, i cili e kundërthotë ndryshimet kushtetuese, reflekton që është një proces që me vetëdije të plotë, ne përpiqemi t'i bëjmë një shërbim. Nuk e dimë a do të shkojë deri në fund apo jo, por na e mban pezull këtë gjë.

Politika ka zhvillime më të caktuara. Mund t'i këputet koka që nesër kësaj pune, nuk ka asnjë problem dhe mund të ecim po me këtë ligj që kemi, por mund të ketë edhe një element të ri kompromisi, i cili na detyron ta shikojmë ligjin. Që ta bëjmë sot, ta shikojmë sot dhe pastaj të ecim nesër kur zemra e problemit edhe këtu vetë ndryshon, them se duhet ta shikojmë në një moment tjetër.

**Fatmir Xhafaj – Faleminderit!**

Siç mund të lexohet lehtësisht, po e quaj një lloj shënimi të projektit, ka një fjali të fundit ku thotë: “Zgjidhjet e mundshme politike lidhur me ndryshimet kushtetuese mund ta ndryshojnë dukshëm mbajtjen e këtij projektligji dhe fjala është vetëm për ato nene që kanë të bëjnë me formatimin e institucioneve”.

Unë jam dakord me këtë gjë që, në rastin e një zgjidhjeje tjetër nga ajo çfarë kemi sot në projektin kushtetues të paraqitur në Kuvend dhe të programuar për t'u debatuar dhe votuar brenda këtij kalendari, nëse ato ndryshojnë pa dyshim që do të afektojnë te ky projektligj, por në një numër të kufizuar dispozitash. Vetëm ato që kanë të bëjnë me formimin e institucioneve.

Pjesa tjetër nuk është e ndërvarur nga mënyra se si formohen institucionet, si voton parlamenti. Pra, nuk i ndryshon funksionet e tyre.

Nga ana tjetër, ne sot thjesht kemi prezantim të projektit, një familjarizim edhe me kolegët për të kuptuar përmbajtjen e projektit, qëllimin e dispozitave të tij, risitë që sjell, problematikat që trajtohen, si dhe për t'u dhënë mundësi kolegëve të bëjnë pyetje dhe në ditët që vijnë besoj se do të jetë edhe shqyrtimi nen për nen, dhe pastaj do të përkojë edhe me momentin që do të ketë një zgjidhje definitive të qëndrimit që ka të bëjë me formatimin e institucioneve.

**Petrit Vasili** – Unë nuk e quaj normale dhe korrekte që të marrim një ligj në dorë, qoftë edhe një nen të vetëm. Ne kemi miratuar një mekanizëm votimi me 3/5-at për një çështje të caktuar, qoftë edhe një pikë të caktuar.

Në projektligjin që vjen këtu në tavolinë ka një reflektim tjetër. Kjo çështje nuk na vë në një pozicion normal, nuk mund të diskutojmë parimisht çështje të cilat ne themi që këto ndryshime lindin nën frymën e kësaj Kushtetute të ndryshuar që po ne vetë e kemi bërë. Këtu duhet të jemi të arsyeshëm për këtë pikë. Jo se unë këmbëngul, por nga pikëpamja formale nuk qëndron.

Së paku, le të rrimë tek ato formulime. T'i jemi besnikë atij drafti që ishte. Nuk ka asnjë të keqe, por këtë nuk mund ta themi, nuk mund ta bëjmë.

Në momentin që nuk kemi një dakordësi politike, e përjashtojmë. Është i përjashtuar dhe vazhdojmë në rregull, sepse kështu kemi rënë dakord. Nuk besoj se do të themi që ne morëm në diskutim një projektligj, që reflekton ndryshimet kushtetuese, por të cilat nuk i respekton.

**Fatmir Xhafaj** – Ne këtu prandaj jemi që në qoftë se nuk ka një gjë që nuk shkon do ta kthejmë të paktën me projektin kushtetues. Jam dakord.

**Petrit Vasili** – Kjo është e shkruar.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord. Prandaj do ta shqyrtojmë.

**Petrit Vasili** – Nuk mendoj që kemi një gabim apo një lapsus në këtë rast me ligjin. Nuk është kështu.

**Fatmir Xhafaj** – Ja t'i pyesim. Gjithsesi, e para, ky është një shqyrtim në tërësi, nuk është një shqyrtim nen për nen, që do të na kushtëzonte në hapat e mëtejshme. Bie dakord që ndoshta edhe ato nene, që janë pjesë e pritshmërisë për të gjetur një zgjidhje, në të mos i trajtojmë dhe mund të vazhdojmë me pjesën tjetër që nuk e ndikon mënyra si do të formatohen .



Gjithsesi nga komenti i drejtë i zotit Vasili ka një pyetje që ngrihet për ju: Pse ka një ndryshim ndërmjet kësaj këtu, që është në projekt dhe asaj që është në projektin kushtetues për sa i përket formatimit e institucioneve ?

**Rainer Deville** –(*flet anglisht*) Neni 174, paragrafi i 14 me ndryshimet kushtetuese ka parashikuar që deri në zgjedhjet e ardhshme 3/5-at do të zëvendësohet me 2/3-at. Kjo ishte formula politike aktuale dhe drafti ka marrë parasysh që kjo njësi do të përcaktohet me kalimin e Kushtetutës më 21 korrik, pra do të jetë e zbatueshme, edhe pse keni të drejtë që ndoshta në mënyrë teknike nuk është shumë e qartë, sepse në teori, për shembull, mund të ketë zgjedhje edhe pas zgjedhjeve të Kuvendit, pra ndoshta 2/3 reflektohet me një dritëshkurtëri. Pra, le të themi 3/5 deri sa të vijë në fuqi 2/3. Ky do të ishte një përcaktim më i mirë, por cilado qoftë marrëveshja politike në fund, sigurisht që ndryshimet do të pasqyrohen këtu, por për hartimin e këtij ligji gjithçka këtu është e hapur. Ne po diskutojmë dhe çfarëdo që të thotë politika, mund ta përfshijmë këtu dhe mbetet një ushtrim *copy paste* për t'u kaluar.

Në fakt, i gjithë ushtrimi është një sfidë për të garantuar vijueshmërinë ose përputhshmërinë e të gjitha ligjeve dhe legjislacioneve. Ligji “Për vlerësimin” duhet të harmonizohet me atë çka del nga Kushtetuta, atë që kemi parë me ligjin e SPAC-ut dhe me parashikimet e përkohshme. Për shembull, u jemi referuar çështjeve që kanë qenë pezull në gjykatën përkatëse dhe e gjitha kjo përkon me ligjin “Për gjykatat”. Pra, kjo duhet amenduar, duhet ndryshuar.

Gjithashtu, këtu kemi një përputhshmëri për statusin e prokurorëve dhe të gjykatësve, sepse edhe në ligjin përkatës thuhet që në nenin 179 përveç parashikimeve transitore, bazuar edhe në vlerësim, ndoshta nuk janë mjaftueshëm strikte nga pikëpamja e procesit të vetingut dhe të antikorrupsionit. Ndoshta duhet të jenë edhe më strikte, më të qarta, më të ashpra, duke u bazuar në legjislacionin tonë dhe duke iu bazuar *status quo-së*, gjithashtu. Është një ndryshim i vazhdueshëm gjithandej dhe duhet ta kemi parasysh kur të mbërrijmë te paketa për të garantuar përputhshmërinë midis elementeve, por gjithçka është ende në ndryshim. Ky ngelet një ushtrim, pra keni shumë të drejtë që duhet të kemi një përputhshmëri të të gjithë paketës, por është vetëm pjesa teknike e të gjithë punës që do të bëhet në fund.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

A ka pyetje? Po, zonja Hysi.

**Vasilika Hysi** – Faleminderit, zoti kryetar!

Do të doja t'ju falënderoja për punën e bërë dhe për kujdesin e treguar në përgatitjen e këtij projekti!

Kam një pyetje për raportet në fazën e parë.

Me të drejtë, zoti Rajner tha që ky është një nga ligjet që do të fillojë zbatimin brenda 20 ditëve nga miratimi i Kushtetutës. Për mua nuk është shumë i qartë raporti midis Avokatit të Popullit dhe Kuvendit. Ne i kemi dhënë të drejtë Avokatit, që, menjëherë sapo të përgatisë listën e përditësuar, ta sjellë në Kuvend, konkretisht në Komisionin e Ligjeve, njëkohësisht, është lënë që 1/5 e deputetëve të kërkojnë votimin e listës...

**Fatmir Xhafaj** – Të lutem, tani...

**Vasilika Hysi** – Jo, është çështje parimore.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Nuk po flas për formulën, por për gjë tjetër.

**Fatmir Xhafaj** – Po filloj diskutimin, ku duhet filluar.

**Vasilika Hysi** – Thuhet: “Kur lista nuk miratohet, rivlerësimi përfundon pa sukses”, pra në rast se nuk miratohet lista në Kuvend ...

**Fatmir Xhafaj** – Të lutem. Ajo është pjesë e një zgjidhjeje.

**Vasilika Hysi** – Edhe kjo është zgjidhje? Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – A ka pyetje të tjera?

Kam unë disa pyetje, ndërkohë që zonja Hysi reflekton.

Meqenëse jemi te reflektimi, unë kam shqetësimin: ky projekt arrin t'i zgjidhë plotësisht rekomandimet që ka pasur opinioni final i Komisionit të Venecias, sidomos në aspektin e respektimit të një procesi të rregullt ligjor dhe të të drejtës së ankimit dhe të kontrollit mbi këtë proces?

Së dyti, në rastin e një përballjeje me Gjykatën Europiane të të Drejtave të Njeriut, sa mund të rezistojnë vendimet e komisioneve të kolegji? Sa janë marrë në konsideratë standardet dhe praktika që ka Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut në raste të tilla analoge?

Së treti, në pikën 3 të nenin 2, ku flitet për organizimin dhe funksionimin e institucioneve, për operacionin monitorues ndërkombëtar, si dhe për rolin e publikut në procesin e rivlerësimit, nga mënyra si do të organizohet dhe si do të funksionojë, operacioni monitorues ndërkombëtar do të jetë pjesë e këtij ligji apo pjesë e marrëveshjes që do të nënshkruhet me partnerët që do ta marrin përsipër këtë proces?

Kam një pyetje teknike te neni 7, pika 3, germa “e” sipas shtojcës së këtij ligji”. Ku është shtojca?

*(Reagim pa mikrofon.)*

Për të qenë objekt i shqyrtimit të projektit.

**Rainer Deville** – *(flet anglisht)* Do të jap përgjigje të shkurtër për shqetësimet. E drejta për apelim garantohet në aneksin kushtetues, në nenin “f” dhe sigurisht e kemi institucionalizuar edhe te zbatimi gjithashtu, ku parashikohet... Ndërsa kemi krijuar një dhomë të veçantë për ankimim dhe kjo dhomë është përcaktuar te neni 6 te “Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut”, pra duhet të ketë një kod, duhet të ketë gjykatës të pavarur, prandaj janë me një kohështrirje të plotë dhe prandaj ata vendosen në gjykatë dhe kjo funksionon si një gjykatë dhe ka statusin e një gjykate. Prandaj, mendoj se kjo është ajo çka kemi parashikuar dhe, gjithashtu, në procese më të përgjithshme janë proceset e drejta, ku gjithçka bazohet në një proces të drejtë, në fakt dhe ky ligj dhe ky ligjzbatues reflekton, së bashku me aneksin e vet, që jemi bazuar në shtetin e së drejtës, edhe nëse gjejmë korrupsion, krim të organizuar i gjithë ushtrimi lufton të gjitha strukturat kriminale me shtetin e së drejtës. Patjetër që ka vështirësi dhe e jemi mbështetur te kodet aktuale procedurale. Gjithashtu, nga këndvështrimi procedural, po t’i referohemi nenit “b” të aneksit, ajo që nuk shpjegohet në ligj, detajet, mënyra si bëhet, si realizohet, varet në marrëveshjen e bërë, varet në mënyrën si organizohet Komisioni Europian dhe do të organizohemi në një formë projekti ose misioni si EURALIUS-i ose OPDAT-it, pra do të jetë një marrëveshje që do të rregullojë gjithçka. Pra, varet gjithashtu edhe nga përzgjedhja e Komisionit Europian, çfarë instrumentesh do të përzgjedhin ata, nga kontributi i SHBA-ve dhe gjithçka tjetër. Gjithashtu, aneksi thotë që duhen edhe disa përpunime të tjera që duhet të finalizohen, neni 3, për shembull “Deklarimi i aseteve, i pronave”, i cili bazohet te standardi i deklaramit të aseteve, që i jemi referuar ILDPI-së, gjithashtu, ka të bëjë me kontrollin e aseteve. Këtë aspekt duhet ta thjeshtojmë; është një format që duhet ta thjeshtojmë disi. Gjithashtu, për vetëvlerësimin, pjesa tjetër është një formulë standarde, që ekziston në procedurën e vlerësimit të prokurorëve dhe të gjyqtarëve, ku thjesht do ta kopjojmë. Ndoshta pika e 4 është struktura e stafit, por kjo varet nga buxheti, i kemi standardet, por na duhet ndoshta edhe një ditë tjetër për t’i riparë dhe për t’i thjeshtësuar, sepse nuk duam që të prodhojmë një aneks shumë të komplikuar, edhe pse ky aneks përfshin ato çka na nevojiten, pjesë e standardit, por mendoj se do të jemi në gjendje ta dorëzojmë këtë sa më shpejt të jetë e mundur, brenda dy-tri ditëve.

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit!

Po, zonja Anastasi.

**Aurela Anastasi** – Faleminderit!

Unë dua të shtojë diçka në lidhje me pyetjen e parë që ju trajtuat, sepse kjo është një pyetje që është ngritur vazhdimisht edhe nga tryeza e konsultimit. E gjithë çështja që shtrohet ka të bëjë me faktin nëse ne kemi realizuar në këtë ligj një mjet ankimor, të paktën një ankim, ndaj një vendimi gjyqësor apo jo. Në fakt, për mendimin tim, ne kemi dy shkallë gjykimi. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, pavarësisht se është një trupë administrative, një autoritet administrativ, ne jemi përpjekur në ligj të përmbushim në lidhje me krijimin, organizmin dhe funksionimin e tij të gjitha standardet që duhet të ketë një gjykim i shkallës së parë. Unë mendoj se vetëm, nëse arrijmë ta konsiderojmë këtë trupë administrative si gjykim të shkallës së parë, ne e kapërcejmë testin në çdo rast. Nëse na mungon ndonjë gjë, natyrisht që duhet ta plotësojmë, por Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është një trupë e tillë administrative që duhet të përmbushë... dhe ne u përpoqëm nëpërmjet kontradikoritetit, të drejtës për t'u dëgjuar të subjektit të rivlerësimit aty dhe mënyrës sesi zgjidhen anëtarët e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, sepse ky organ duket si një organ kuazi gjyqësor, por që përmbush të gjitha e kriteret e gjyqimit në shkallë të parë, në mënyrë që të paktën të realizojmë një ankim kundër vendimeve të tij. Këto i realizojmë nëpërmjet Kolegjit të Posaçëm, i cili përmbush të gjitha kriteret që duhet të përmbushë Gjykata Kushtetuese dhe vendimet e komisionit mund të ankimohen aty si nga pikëpamja materiale, ashtu edhe nga pikëpamja procedurale, të cilat ai është i aftë t'i gjykojë të dyja. Ky ishte shqetësimi. Kemi edhe raste të tjera, kur ne ecim në këtë mënyrë.

Fjala vjen, kolegjet zgjedhore kështu funksionojnë. Ankimet ndaj Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kalojnë pikërisht në këto kolegje zgjedhore. Them se kjo është një skemë e ngjashme, megjithatë ne jemi përpjekur që t'i përmbushim të gjitha kriteret, për të qenë një gjykim i shkallës së parë dhe rivlerësim, praktikisht ai kryen rivlerësim, rivlerësimi që kryen Komisioni i Pavarur, të mos i mungojë një gjë e tillë. Faleminderit!

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit!

Ka pyetje të tjera?

Urdhëroni, zoti Manja!

**Ulsi Manja** – Gjithmonë lidhur me respektimin e një procesi të rregullt dhe të drejtë e kam shqetësimin. Tani kemi Komisionin e Pavarur të Kualifikimit dhe kemi Kolegjin e Apelit, që do të jetë pranë Gjykatës Kushtetuese.

Në fakt, vetë drafti kushtetues përdor dy terma; anëtar për Komisionin e Pavarur të Kualifikimit dhe gjyqtar në rastin e Kolegjit të Apelit. Pavarësisht se ndjekin rregulla kuasi gjyqësore, sepse i referohen Kodit të Procedurës Administrative, pyetja është: këto dy komisione, pra flas për komisionin dhe për kolegjin, nuk janë organe të mirëfillta gjyqësore, por edhe në mënyrën e gjykimit vërtet do të ketë një të drejtë të apelit ndaj vendimit Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, kolegji, sipas përcaktimeve kushtetuese, por dhe siç janë reflektuar këtu në ligj, gjykon i pavarur nga komisioni dhe nga del kjo. Del, sepse nuk ka të drejtën të prishë vendimin e komisionit dhe t'ia kthejë për rigjykim komisionit, pra është i pavarur në vendimmarrje Kolegji. Pyetja ime është e tillë, ndaj vendimit të Kolegjit të Apelit, ku do të jetë e drejta e ankimit, ka të drejtë ankimi ndaj vendimit të Kolegjit? Nuk po them për thelbin apo përmbajtjen e vendimit, po i rri strikt respektimit të procesit të rregullt dhe procedurës, ku do të ankimohet në fund gjyqtari dhe prokurori ndaj vendimit të Kolegjit të Apelit?

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit!

Urdhëroni, zonja Anastasi!

**Aurela Anastasi** – Faleminderit!

Dua të them diçka në lidhje me konsideratën tua, lidhur me karakterin gjyqësor ose jo të Kolegjit të Posaçëm të Apelit. Ata janë gjyqtarë dhe jo pa qëllim janë zgjedhur në mënyrë të atillë, është garantuar një status gjyqtari dhe për më tepër mandati. Madje, unë mendoj se ne duhet ta kemi këtë pyetje kur të vijë puna për Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, kurse Kolegji i Posaçëm i Apelit është totalisht i përputhur me kërkesat për një gjykatë. Për më tepër ai nuk është gjë tjetër veçse një kolegji i dytë i Gjykatës Kushtetuese. Gjykata Kushtetuese do të funksionojë për atë periudhë, 9-vjeçare, sa është aty, me këto dy kolegje. Kurse mosparashikimi nga ana jonë i prishjes së vendimit dhe kthimit për rigjykim në komision, nuk ka ardhur për shkak se nuk kemi të bëjmë me gjykata, në këtë rast, ose të ankimit të tipit gjyqësor, por ka ardhur si një nga ato masa që ne morëm për shkak të përkohshmërisë dhe të shpejtësisë me të cilën duhet të punojmë në këtë ligj. Ne kemi parasysh përvojat në gjykimin e zakonshëm. Prishja e vendimit nga Gjykata e Apelit ose Gjykata e Lartë dhe kthimi për rigjykim në një instancë tjetër, ka sjellë zgjatje të pafundme të afateve të gjykimit. Ne e morëm këtë si një masë për të mos

shkaktuar zgjatje të afateve, por që Kolegji e prish vendimin dhe vendos, mendojmë se kjo është një zgjidhje.

Në lidhje me faktin nëse mund të ankimohen më, e vetmja mundësi do të ishte të ezauronin brenda mjeteve të ankimit të brendshëm vetëm në Gjykatën Kushtetuese. Meqenëse ky Kolegj është vendosur pranë Gjykatës Kushtetuese dhe përmbush standardet e një gjykimi kushtetues, ne mendojmë se nuk ka vend më, ata mund të shkojnë te kolegji tjetër i Gjykatës Kushtetuese. A ka më kuptim të shkojnë te një kolegji tjetër po tek i njëjti organ kolegji, i cili e ka shqyrtuar një herë, ka shqyrtuar edhe përmbajtjen nga ana materiale edhe procesin, atë që ju keni shqetësim me shumë të drejtë. Nuk kemi ndonjë standard që një gjykatë të shqyrtojë përmbajtjen e vendimit dhe tjetra duhet të shqyrtojë procesin. Ne mendojmë se ky kolegji mund t'i shqyrtoj të dyja: edhe anën materiale, edhe procesin. Ndërkohë, është e hapur rruga për Strasburg, sepse edhe të duam ne, nuk mund ta ndalojmë dot. Faleminderit!

**Fatmir Xhafaj** – Urdhëroni, zonja Hysi!

**Vasilika Hysi** – Në fakt, nuk kisha ndërmend të pyesja, sepse do i ruaja për nen për nen. A keni ndonjë praktikë, ku Gjykata Europiane pranon, pa të drejtë ankimi, të themi, që procesi ligjor është arritur? Varianti i dytë, edhe nëse ankimi ushtrohet brenda të njëjtës gjykatë, por nga kolegje të ndryshme, e kanë quajtur proces të rregullt ligjor dhe e kanë njohur këtë si një mënyrë ankimi?

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit!

Urdhëroni, zonja Anastasi!

**Aurela Anastasi** – Faleminderit për pyetjen!

Shqetësimi juaj është shumë i drejtë edhe shqetësimi ynë ky është. Ne në qoftë se do të kemi ndonjë rast për të çuar në Strasburg t'i rezistojmë Strasburgut. Për këtë na duhen për të garantuar dy gjëra këtu.

Së pari, meqenëse nuk kemi shumë mjete të brendshme, por kemi vetëm dy, patjetër na duhet që të realizojmë termin ligjor “gjykatë” për të dyja këto hallka gjykimi. Kjo do të thotë se nuk është e thënë që ne t'i quajmë gjykata, por ato duhet të jenë krijuar në mënyrë të tillë, që t'i përmbushin të gjitha kriteret që të quhen gjykata.

Për mua më i rrezikuar është komisioni i pavarur i kualifikimit (për t'u diskutuar nga kjo pikëpamje), ndërsa kolegji i posaçëm i apelimit është më i kompletuar nga kjo anë. Unë mendoj se me këtë ligj realizojmë (nëse s'e kemi realizuar, do ta rishikojmë edhe një herë), që

komisioni i pavarur i kualifikimit është një autoritet administrativ që i përmbush kriteret e të qenurit gjykatë e caktuar me ligj, sikurse e kërkon Strasburgu.

E dyta, duhet të garantojmë që të kemi vetëm një mjet ankimi, sepse kaq kërkon edhe Organizata e Gjyqtarëve Ndërkombëtarë dhe Europianë. Ajo thotë: “Të kenë së paku një mjet ankimi ndaj një vendimi gjyqësor. Kështu që ky është një proces i përkohshëm, që kryhet shumë shpejt. Së paku do të ketë një mjet ankimi ndaj vendimit gjyqësor. Nuk ka kuptim (në gjykimin tim), të ketë ankim edhe në kolegjin e posaçëm të apelimit, pranë Gjykatës Kushtetuese, njëkohësisht, edhe ankimim në kolegjin ekzistues të Gjykatës Kushtetuese. Edhe po të jetë kryer rivlerësimi i tyre, sepse gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese do të trajtohen me prioritet në kohë dhe gjatë kohës që punon komisioni i pavarur i kualifikimit, ata mund ta kenë përfunduar rivlerësimin e tyre. Nuk më duket se ka kuptim kjo. Nuk di të them ndonjë rast konkret, në lidhje me këto dy kolegje të përplatura në një gjykatë, por Gjykata e Strasburgut kërkon elementet e të qenit gjykatë e shkallës së parë dhe e shkallës së dytë, për ta konsideruar të realizuar procesin të rregullt edhe me gjykim, edhe me ankim në shkallën e parë. Ajo kërkon një proces ankimi, me përjashtim të disa rasteve që i ka përcaktuar vetë, me protokollin shtesë (numër 7 kam përshtypjen). Ajo i ka përcaktuar vetë ato raste, por nuk mendoj se këto raste përputhen me rastin tonë. Ne thjesht duhet t’i konsiderojmë këto organe, si organe të afta për të qenë gjykata. Ky është shqetësimi ynë, si ekspertë. Faleminderit!

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit, zonja Anastasi!

Besoj se edhe përgjigja është shumë shtjelluese dhe besoj se jemi pak a shumë të qartë për këndvështrimin që kanë pasur ekspertët në përputhje me rekomandimin e opinionit final të Komisionit të Venecias, me çështjet e trajtuara gjatë konsultimit publik, por edhe me praktikën e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, edhe të standardeve ndërkombëtare që do të duhet të garantohen minimalisht në të gjithë këtë proces tepër të veçantë, sepse natyra e veçantë e procesit përcakton natyrisht, edhe disa procedura të veçanta.

Pavarësisht nga kjo, është e domosdoshme që të ruhen dhe të garantohen disa elemente të domosdoshëm të procesit të rregullt ligjor. Zonja Anastasi dha argumentet, pikërisht për këtë lloj qasjeje, këtë lloj këndvështrimi të tyre në hartimin e projektit.

Ka të tjera pyetje? Nuk ka.

Edhe një herë, shumë faleminderit, zonja Anastasi, zoti Deville, zoti Smibert për prezencën dhe për përkushtimin ndaj këtij procesi në tërësi dhe ndaj këtyre dy projektligjeve në veçanti!

Natyrisht, janë për t'u riparë në ditët e ardhshme gjatë shqyrtimit dhe votimit në parim dhe nën për nën të këtyre dy projektligjeve të rëndësishme.

Ndërkohë, do të vazhdojmë me shqyrtimin nën për nën të projektligjit tjetër, projektligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve”.

Dua t'ju bëj me dije se sekretariati i komisionit ka përgatitur edhe procesverbalet e mbledhjeve të mëparshme dhe është duke i bërë publike përmes faqes *web* të Komisionit për Reformën në Drejtësi. Besoj se jeni dakord me to. Le t'i konsiderojmë edhe këto dokumente si të miratuara. Nëse ka ndonjë gjë gjatë leximit të procesverbaleve, deputetët janë të lutur t'ia përcjellin sekretariatit për t'i reflektuar si detaje. Le t'i konsiderojmë si të miratuara dhe të vazhdojmë me publikimin e tyre sipas rregullave që ka Kuvendi dhe vetë ky komision në faqen përkatëse.

Ndërkohë, do të vazhdojmë me shqyrtimin nën për nën të projektligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve”.

**Fatmir Xhafaj** – ...neni 64, ku e kemi lënë mbledhjen e kaluar, që është “Emërimi i përkohshëm”.

Po, zonja Hysi.

**Vasilika Hysi** – Faleminderit, zoti kryetar!

Për transparencë, do të doja të theksoja që grupi i ekspertëve, i cili ka punuar për këtë projektligj, nën drejtimin e misionit EURALIUS, zonjës Agnes, ka punuar gjatë gjithë periudhës (nga kalimi i mbledhjes së fundit dhe gjatë fundjavës) bazuar në tabelën që u kemi vënë në dispozicion, u ka dhënë përgjigje shumë prej pyetjeve që ne kemi parashtruar nën për nën qoftë për kapitullin që do të fillojmë “Për mandatin e kufizuar” dhe në vazhdimësi.

Shumë nga këto riformulime janë marrë në konsideratë, por ndërkohë dua të theksoj që, meqenëse ky kapitull është i ri, është një risi në praktikën shqiptare, krahas pyetjeve, në fillim të çdo seksioni do të doja që zonja Agnes, shumë shkurt, të na jepte një përmbledhje të risive për të bërë kuptimin më të mirë të këtyre instituteve të reja që janë krijuar. Kjo nuk është për anëtarët e komisionit, se këta të fundit e kanë lexuar, por për të lënë rekorde të regjistruara të këtyre



mbledhjeve për ata që duan të kuptojnë pse këto dispozita janë formuluar në një formë të caktuar a një formë tjetër. Me të vërtetë kjo është risi për të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët në Shqipëri.

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit!

Po, zonja Bernhard.

**Agnes Bernhard** – *(flet anglisht)* Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, anëtarë të komisionit!

Do të doja të bëja një prezantim të shkurtër për këtë kapitull. Në fakt, kjo është një risi dhe synon të adresojë deficiencën në atë që ekziston në sistemin aktual, që do të thotë se nuk ka një kuadër koherent për të garantuar fleksibilitetin e gjyqtarëve dhe zgjidhjet për gjyqtarët ose prokurorët, të cilët kanë të drejtë të kthehen në pozicionet e tyre të mëparshme, sipas këtij kuadri. Pra, qëllimi i përgjithshëm i këtij kapitulli është të garantojë një zhvillim karriere të sigurt, të zhvilluar, si dhe të garantojë kapacitetet dhe aftësitë që gjyqtarët fitojnë në gjykatat e karrierës së tyre, që këto aftësi t'i ofrohen shoqërisë.

Po jap një shembull: gjyqtarët mësojnë në karrierën e tyre sesi të zbatojnë Kodin Penal. Kjo njohuri duhet përdorur edhe në Ministrinë e Drejtësisë, në Departamentin e Kodifikimit, si departamenti përgjegjës për të adresuar zhvillimet e reja në shoqëri dhe duhet të shkruajë, të pasqyrojë zhvillimet në Kodin Procedural. Pra, ekspertiza e tyre do t'i ofrohet organit legjislativ të qeverisë ose gjyqtarët, të cilët kanë performuar shumë mirë, kanë pasur një sukses në karrierën e tyre, duhet të jenë të disponueshëm për shërbimet inspektuese, të cilat janë të rëndësishme në një sistem, sepse kanë detyrën për të garantuar llogaridhënien e sistemit dhe në periudhë afatgjatë duhet të garantojnë që sistemi të jetë i pastër. Pra, në këto pozicione ose në pozicionet e gjykatave Kushtetuese duhet të garantojmë që të kemi njerëz shumë të kualifikuar dhe të mirë atje. Për ta garantuar këtë gjë duhet t'u jepni gjyqtarëve mundësinë të lënë për një kohë të caktuar pozicionet e tyre si gjykatës dhe të shërbejnë në pozicionet respektive. Por, për t'u dhënë më të mirëve stimulin për ta dhënë këtë shërbim ndaj shoqërisë, duhet të garantoni që kur ai të përfundojë komandimin ose mandatin e kufizuar ta ketë vendin në dispozicion, pra ky vend nuk do t'i zihet nga një person tjetër.

Ky kapitull tani parashikon rregullat sesi duhet të menaxhojmë skemën e zhvillimit të karrierës, të parashikuar në këtë ligj. Prandaj neni 64 përcakton një skemë për emërimin e përkohshëm, që do të thotë: nëse një gjykatës është gjykatës në Gjykatën e Apelit të Tiranës, me një mandat të përhershëm, dhe është dakord të shkojë tek Inspektorati i Lartë i Drejtësisë,

ndoshta për pesë ose dhjetë vjet, në këtë periudhë dhjetëvjeçare posti i tij do të rezervohet, pra do të ruhet për të. Domethënë, në gjykatën respektive ai ka të garantuar një pozicion, që është i lirë për t'u plotësuar nga të tjerët, por për një kohë të limituar, për aq kohë sa ai të kthehet përsëri në pozicion. Ligji ofron mundësinë për ta mbushur përkohësisht këtë pozicion të përkohshëm. Nëse ky pozicion mbushet ose zihet përkohësisht, personi që e plotëson, e mbush atë, duke u larguar nga gjykata e tij, ku ka vendin e përhershëm, ai lë aty gjithashtu një vend tjetër të përkohshëm të lirë. Kjo krijon mundësinë për një vend vakant të përkohshëm, gjithashtu. Pra, i gjithë ky sistem duhet të administrohet, çka krijon mundësinë, nga njëri krah, për gjykatësit që të jenë më fleksibël për të mësuar nga eksperiencat jashtë sistemit dhe, nga ana tjetër, për të pasur garancinë se do të kthehen në fund të mandatit të tyre në pozicionet e tyre të mëparshme.

Kjo skemë nuk është shpikur, por është një skemë që përdoret edhe në vendet e tjera europiane, që tregojnë se funksionon dhe se mund të zbatohet. Patjetër, kushti që kjo skemë të zbatohet është që duhet të jetë dikush që të kujdeset për atë. Këta janë njerëz që dedikohen me kohë të plotë për të kontrolluar sistemin, por kjo garantohet edhe me anën e një këshilli (me anëtarë me kohë të plotë, me logjistikën dhe infrastrukturën mbështetëse, me mbështetjen e teknikëve të informacionit e kështu me radhë), pra me të gjithë asistencën e nevojshme.

Ne rishikuar propozimin e komisionit *ad hoc* dhe kemi përpunuar ose e kemi riformulimin në tekst.

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit, zonja Bernhard!

Po, zonja Hysi.

**Vasilika Hysi** – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zonja Agnes, për prezantimin dhe qartësimin!

Lidhur me këtë seksion, me nenin 64 që bën fjalë për emërimin e përkohshëm, shqetësimet ose pyetjet që kishim ngritur janë: “Në cilat raste krijohet vakancë dhe si plotësohet?”, pothuajse janë marrë në konsideratë. Të gjithë paragrafët e këtij neni janë saktësuar nga grupi i ekspertëve dhe zonja Agnes. Formulimi i ri i çdo paragrafi të nenit 64 është në materialin që ka ardhur, ku pasqyrohen të gjitha ndryshimet me *track changes* (ku është fshirë dhe ku është...), konform shqetësimeve që ne kemi ngritur.

**Fatmir Xhafaj** – Atëherë, biem dakord me nenin 64, me ndryshimet e propozuara?

(*Të pranishmit shprehen dakord.*)

Dakord.

Kalojmë te neni 65.

**Vasilika Hysi** – Neni 65 ka të bëjë me të drejtën e kthimit. Ky nen është riformular sipas propozimeve të ngritura ose pikëpyetjeve për qartësinë e tyre.

**Fatmir Xhafaj** – Atëherë, biem dakord edhe me nenin 65, me ndryshimet?

*(Të pranishmit shprehen dakord.)*

Dakord.

Neni 66.

**Vasilika Hysi** – Neni 66 ka të bëjë me kufizimin e mandatit me ligj. Në fakt, titulli nuk ishte shumë i qartë, ndaj në këtë kuadër kemi bërë disa pyetje dhe janë bërë disa formulime të vogla. Them se ndryshimet e bëra janë të kënaqshme, çka e sjellin nenin në formën e duhur.

**Fatmir Xhafaj** – Ka ndonjë gjë tjetër për nenin 66?

**Vasilika Hysi** – Në nenin 66 e vetmja gjë që duhet ta mbajmë në konsideratë ka të bëjë me dispozitat kalimtare, sepse në kreun e fundit...

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Fatmir Xhafaj** – Dakord, dakord, por kur të shkojmë aty për t'u referuar.

**Vasilika Hysi** – Më falni, në pikën 3 të këtij ligji bëhet fjalë për sa kohë do të qëndrojë në detyrë gjyqtari. Në fakt, zonja Agnes, edhe nga diskutimi që kemi bërë para se të hynim në mbledhje, thekson që, referuar nenit 136 të Kushtetutës, paragrafi 5, është zgjidhur më së miri vazhdimësia e punës së gjyqtarit të Gjykatës së Lartë kur i mbaron mandati derisa të vijë gjyqtari i ardhshëm. Pra, sipas ekspertëve, kjo është zgjidhur duke bërë referimin te neni 136, paragrafi 5 i Kushtetutës.

Shqetësimi im lidhet me vendimin e fundit të Gjykatës Kushtetuese, pra sa gjatë duhet të qëndrojë gjyqtari në detyrë, por, nga ana tjetër, ky problem është zgjidhur edhe me faktin që në paragrafin e pestë të këtij ligji, zoti kryetar, është përcaktuar që Këshilli detyrohet ta përfundojë procedurën e ngritjes në detyrë të gjyqtarit pasardhës jo më vonë se data e mbarimit të mandatit.

Vënia e këtij kriteri në ligj e zgjidh më së miri faktin se nuk mund të kemi më gjyqtarë të Gjykatës së Lartë që të rrinë pafundësisht derisa të zgjidhet gjyqtari pasardhës. Pra, është përcaktuar edhe se sa do të zgjasë procedura që do të ndjekë këshilli për ngritjen në detyrë të gjyqtarit pasardhës.

Kombinimi ose rregullimi në paragrafin e tretë dhe të pestë të këtij ligji zgjidh çdo lloj shqetësimi që mund të haset në praktikë.

**Fatmir Xhafaj** – Në rregull.

Biem dakord edhe me nenin 66, me ndryshimet e propozuara.

Neni 67?

**Vasilika Hysi** – Lidhur me nenin 67 “E drejta për emërimin në nivel apeli” është rregulluar emërtimi, duke e bërë: “E drejta për caktimin në nivel apeli”, por gjithashtu edhe shqetësimi ose pyetja që unë kisha ngritur: Nëse një gjyqtar i Gjykatës së Lartë, në mbarim të mandatit të tij, kalon në një gjykatë të nivelit të ulët, a do ta ruajë pagën ose do të marrë pagën e re të nivelit më të ulët? Është sqaruar se do të ketë pagën e nivelit ku ai do të shkojë. Në këtë mënyrë zgjidhet edhe kjo paqartësi.

Kjo është arritur më së miri, pasi në nenin 67 janë riformuluar të katër paragrafët, duke e përafëruar edhe me kërkesat më të larta që kërkon teknika legislative.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord, vetëm se kam një merak: riformulimi i pikave të këtij neni e zgjidh mënyrën kaq konfuzë që është thënë te pika 1, ku të krijohet përshtypja se edhe prokurori i Përgjithshëm, edhe ai i zyrës së posaçme shkon në Gjykatën e Apelit?

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Këtu duhet ndarë: ai që është gjyqtar i Gjykatës së Lartë shkon në Gjykatën e Apelit, kurse ai që është prokuror i Përgjithshëm dhe ai i Zyrës së Prokurorisë së Posaçme duhet të shkojnë në linjën e... Karrierën e tyre e kanë brenda sistemit të prokurorisë. Pra të mos ketë ngatërrim ndërmjet dy karrierave.

Duhet riformuluar më qartë kjo gjë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Zonja Agnes, doni të bëni një ndërhyrje?

**Agnes Bernhard** – *(flet anglisht)* Po, doja të thosha që ne propozuam shtimin e një fjalie, e cila e bën më të qartë hierarkinë e këtyre të drejtave për t’u rikthyer në vendin e punës. Prioriteti i parë do të ishte: ata persona kanë të drejtë të rikthehen në pozicionet e mëparshme; prioriteti i dytë është e drejta për t’u përcaktuar ose për t’u emëruar në nivel apeli dhe niveli i tretë i hierarkisë është e drejta për t’u transferuar, në përputhje me nevojat e transferimit, duke pasur parasysh edhe ristrukturimin e sistemit gjyqësor.

E treta, duhen reflektuar edhe nevojat e lëvizjeve paralele. Pra, në këtë rast kemi më shumë të drejta dhe për këtë arsye ne duhet të fusim këtë hierarki. Ndaj ne propozojmë ta paraqesim këtë hierarki këtu.

**Vasilika Hysi** – Zonja Agnes, unë do të rimarr përsëri pyetjen e kryetarit Xhafaj. Në rast se prokurorit të Përgjithshëm ose prokurorit në zyrën e prokurorisë së posaçme, që e ka mandatin e limituar, i mbaron mandati, do të shkojë në Prokurorinë e Apelit apo do të shkojë në Gjykatën e Apelit? Sepse mënyra siç është lënë, formulimi i ri i sjellë i paragrafit të parë thotë që këta shkojnë në nivel apeli. Respektivisht mund të shkojë një prokuror i përgjithshëm në Gjykatën e Apelit, ose prokurori i Zyrës së Prokurorisë së Posaçme në Gjykatën e Apelit, ose anasjelltas? Kryetari i Gjykatës së Lartë të shkojë në Prokurorinë e Apelit?

**Agnes Bernhard** – (*flet anglisht*) Ideja këtu është që ata shkojnë në strukturat e tyre respektive. Pra, prokurorët do të shkojnë brenda sistemit të prokurorisë dhe gjyqtarët brenda sistemit të gjyqësorit. Ne do ta qartësojmë këtë nëse këtu nuk del e qartë.

**Vasilika Hysi** – Faleminderit!

Unë e vlerësoj faktin që keni shtuar hierarkinë e disa kritereve për të përcaktuar dhe hierarkinë e vlerave, si dhe radhën e plotësimit ose të caktimit në nivelin e apelit. Kjo është një gjë pozitive me qëllim që të shmanget çdolloj përdorimi abuziv apo të ndodhë ajo që ka ndodhur sot, që drejtuesja e Gjykatës së Lartë, apo ish-prokurorja e Përgjithshme janë ende pa punë. Pra, nuk kanë gjetur pozicionin e tyre të punës, sepse pozicionet e tyre janë zënë nga persona që kanë kaluar dhe ata qëndrojnë në listë pritjeje, ose nuk marrin emërime për një kohë të gjatë, siç është dhe rasti i zonjës Subashi. Në praktikën tonë kemi disa raste që personat kanë qenë të detyruar të marrin detyra të rëndësishme në institucionet tona shtetërore dhe më pas kanë ngelur pa punë, siç janë dhe sot. Pra, mua më vjen mirë për shtesën që keni bërë te paragrafi 3. Zoti kryetar, unë nuk kam gjë tjetër për këtë nen.

**Fatmir Xhafaj** -Besoj se është e qartë në kuptimin që do të ristrukturohet, do të riformatohet neni. Se dhe kjo e drejta për emërim në nivel apeli nuk është shumë e goditur. Po të shikosh pikën 2 nuk të krijon idenë që është vetëm për apel. Miratohet me ndryshimet.

Neni 68. Mbarimi i mandatit të kryetarit...

**Vasilika Hysi** -Zoti kryetar, për këtë nen kishim drejtuar disa pyetje. A ka kritere për zgjedhjen e kryetarit? Kur mbaron mandati? Po të shikoni, grupi i ekspertëve e ka riformuluar paragrafin e parë. Te paragrafi i dytë gjithashtu ka bërë qartësimin e pikës “b” pikërisht duke zgjidhur atë problemin e shqetësimit që ne kemi për terminologjinë.

**Fatmir Xhafaj** -Është fjala për mandatin e kryetarëve të gjykatave të shkallëve të para dhe të apelit.

**Vasilika Hysi** – Dhe të prokurorive.

**Fatmir Xhafaj** – Nuk është i njëjti rregull për mandatin e kryetarit të Gjykatës së Lartë, kështu që duhet specifikuar pak.

**Vasilika Hysi** – Ky është mbarimi i mandatit të kryetarëve të tjerë, sepse mandati i kryetarit të Gjykatës së Lartë, apo i prokurorëve është më vete. Prokurori i Përgjithshëm e ka më vete në një ligj të veçantë dhe këtu kemi një dispozitë kalimtare. Megjithatë zonja Agnes mund të na japë më shumë informacione.

**Fatmir Xhafaj** – Sepse që në fillim ai nuk është me të drejtë rizgjedhjeje.

Po, zonja Agnes.

**Agnes Bernhard** *-(flet anglisht)* Pra, kjo dispozitë i referohet vetëm kryetarit me një mandat prej 3 vjetësh dhe me të drejtën e një rizgjedhjeje. Rizgjidhet vetëm një herë dhe kjo nuk i referohet kryetarëve me një mandat më të gjatë. Pra, ka një rregull të përgjithshëm vetëm për ata kryetarë të cilët kanë një mandat 3-vjeçar dhe mandati i të cilëve mund të shtyhet, ndërsa kryetarët e tjerë të gjykatave të nivelit të parë apo të nivelit të dytë, apo të zyrës së prokurorisë së nivelit të parë dhe të prokurorisë së nivelit të dytë. Prokurori i Përgjithshëm ka një mandat të veçantë të posaçëm. Dispozita të veçanta ka edhe për kryetarin e Gjykatës së Lartë. Por nëse nuk e del e qartë këtu ne mund t'u referohemi shprehimisht këtyre personave.

**Fatmir Xhafaj** – Jeni dakord me ndryshimet në nenin 68? Dakord. Faleminderit!

Neni 69. Kohëzgjatja në detyrë e magjistratëve.

**Vasilika Hysi** – Zoti kryetar,

Nëse ju kujtohet edhe nga mbledhja e kaluar, te materiali i punës që kemi, tabela, unë konstatova një dallim midis përmbajtjes së këtij kreu, kreut 7, dhe titullit. Në draftin e sjellë thuhet ndërprerja e mandatit. Në fakt këtu nuk bëhet fjalë për ndërprerje mandati, këtu flitet për mbarim të mandatit, pra të statusit të magjistratit, ose të emërimit. Pra, kjo është një çështje që mendoj se ka qenë çështje përkthimi dhe në këtë kuadër ka nevojë që titulli t'i përkojë përmbajtjes. Dhe me të drejtë ekspertët e kanë riparë dhe e kanë bërë unifikimin e titullit të kreut me përmbajtjen e kreut. Dhe këtu titulli do të lexohet nga ndërprerja e mandatit te mbarimi i statusit të magjistratit, ose të emërimit. Mund të pranohet njëra nga këto të dyja dhe ne jemi konform...

Gjithashtu, neni 69, përveç titullit, kohëzgjatja në detyrë e magjistratit është riparë për t'u riformuluar në përputhje me gjuhën kushtetuese dhe teknikën legjislative. Njëkohësisht ka

ndryshuar edhe është riparë pika 4, pika 5, si dhe në vazhdimësi. Kam pasur një pyetje nëse ju kujtohet lidhur me moshën e pensionit. Pra, kur mund të dalë në pension gjyqtari i Gjykatës së Lartë ose prokurori i Përgjithshëm? Në projektligj është vendosur moshë 70 vjeç, me të vetmin kusht që anëtarit të Gjykatës së Lartë, me mbushjen e moshës, i mbaron mandati, pavarësisht nga vitet ushtrimit të funksionit në këtë pozicion, por njëkohësisht edhe për prokurorin e Përgjithshëm. Ky besoj se ka qenë një vendim politik, nuk është një zgjedhje e ekspertëve, ishte një pyetje që unë e shtrova se kur duhet të dalë në pension magistrati. Ne si politikbërës nuk mund t'ia kërkojmë përcaktimin e moshës. Këta kanë sjellë një sugjerim për të pasur moshën 70 vjeç dhe të mos më lënë pastaj interpretime lidhur nëse duhet të vazhdojë një person ose jo. Pjesa tjetër pastaj është riformuluar sipas kërkesave që ne kemi parashtruar.

**Agnes Bernhard** - *(flet anglisht)* Për sa i përket moshës në mënyrë praktike mund të vazhdojë situata aktuale që ju keni parashikuar tashmë në Kushtetutë. Pra, për daljen në pension në moshën 70-vjeçare, por kjo nuk përfshihet në të gjitha ndryshimet kushtetuese. Për këtë arsye ky ligj ka marrë çfarë ka qenë më përpara në Kushtetutë. Ndërsa për të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët e tjerë, për sa i përket daljes së atyre në pension, kjo përcaktohet me ligjet përkatëse që janë në zbatim ashtu siç është edhe sot.

**Vasilika Hysi** – Faleminderit, zonja Agnes, por tani më provokuat me këtë që thatë. A nuk do të ishte më mirë që moshë 70 vjeç të përcaktohej në Kushtetutë? Se ne kemi thënë kur mbush moshën e pensionit. Dhe mund të ndodhë që dikush të pyesë që moshën e pensionit e përcakton ligji “Për pensionet”. Dhe për të shmangur këtë gjë, përderisa është rënë dakord që duhet të jetë moshë 70 vjeç, them kur mbush moshën 70 vjeç. Pra, kufizimin ta bëjmë me ligj, ndërkohë që Kushtetuta thotë që mbush moshën e pensionit. Moshë e pensionit nuk është 70 vjeç. Moshë e pensionit, në bazë të skemës së re të pensioneve, lëviz sipas viteve të punës dhe vitit kur personi del në pension.

**Agnes Bernhard** – *(flet anglisht)* Ju mund ta argumentoni se ligji përkatës për gjyqtarët e Gjykatës së Lartë dhe Prokurorisë së Përgjithshme është ligji “Për statusin”. Ndërsa për gjyqtarët dhe prokurorët e tjerë i referohen ligjit përkatës “Për pensionet”. Pra, për të dyja është e përcaktuar me ligj. Kështu që nuk besoj se do të ketë ndonjë dallim të madh këtu. Ju deri tani e keni pasur këtë dallim për kategoritë e ndryshme të gjyqtarëve. Kjo gjë i shton një standard të cilin ju do ta gjeni dhe në shumë vende të tjera në Europë. Për shembull në Austri të paktën gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese punojnë deri në moshën 70-vjeçare, ndërsa gjyqtarët e tjerë

punojnë deri në moshën 65-vjeçare. Pra, dhe këtë mund ta argumentoni që gjyqtarët e nivelit më të lartë kanë dhe mbështetje më të madhe, dhe për këtë arsye mund të punojnë edhe për më gjatë. Kjo lidhet gjithashtu me përvojën, mençurinë që ata kanë marrë gjatë gjithë këtyre viteve.

Pra, këto janë argumentet që ju mund t'i përdorni për dallimin e daljes në pension të gjyqtarëve që janë në nivele më të larta dhe të gjyqtarëve që janë në nivele më të ulëta. Pra, unë nuk e gjej si të pazakontë që të kemi këtu një ligj specifik të posaçëm për moshën e daljes në pension të këtij grupi të posaçëm. Ndërsa për grupin tjetër thjesht mund t'i referohemi skemës së përgjithshme, por përsëri ky mbetet një vendim i politikës.

**Vasilika Hysi** – Nuk kam gjë tjetër për këtë nen.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 69. Dakord me ndryshimet.

Neni 70. Dorëheqja.

**Vasilika Hysi** – Te neni 70 pyetja që ishte shtruar, dorëheqja nënkupton mbarimin apo përfundimin që magjistrati mund të qëndrojë në një pozicion, është bërë një riformulim dhe është qartësuar që flitet për mbarimin e qëndrimit nëpërmjet dorëheqjes. Te neni 70 paragrafi i parë dhe dytë janë riformuluar për të qenë konform teknikës legjislative.

**Fatmir Xhafaj** -Dakord me ndryshimet e bëra.

Neni 71.

**Vasilika Hysi** – Për nenin 71 kemi kërkuar që të riformulohej. Pse është përdorur termi “për shkak të ligjit”? Me të drejtë grupi i ekspertëve, zonja Agnes, ka sjellë një riformulim të ri për nenin. Në vend të fjalëve “mbarimi i kohëzgjatjes së pozicionit për shkak të ligjit” e ka titulluar “pazgjedhshmëria dhe papajtueshmëria” dhe kjo është më se e drejtë. Të gjitha paragrafet më pas janë riformuluar për të pasur një gjuhë të qartë, të thjeshtë, paekuivok të rregullimit të rasteve të pazgjedhshmërisë dhe të papajtueshmërisë.

**Fatmir Xhafaj** - Biem dakord me nenin 71 me ndryshimin e titullit dhe me ristrukturimin e dispozitës. Jeni dakord.

Miratohet me ndryshimet e bëra.

Neni 72. Paaftësia fizike dhe mendore e një magjistrati.

**Vasilika Hysi** – Zoti kryetar, për këtë nen nuk kemi pasur probleme të përmbajtjes. Kemi pasur vetëm dy probleme. Terminologji, paaftësi fizike dhe mendore. A mund të jetë kompetent këshilli të vendosë për aftësinë fizike dhe mendore të një magjistrati dhe të kërkojë më pas largimin e tij nga funksioni ose pezullimin e përkohshëm? Ky nen është riformuluar nga



ekspertët dhe zonja Agnes. I vetmi shqetësim që unë kam është se, meqenëse Shqipëria ka ratifikuar konventën për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar dhe kemi marrë një letër zyrtare, ju, si kryetar komisioni, për terminologjinë, ta verifikojmë dhe një herë terminologjinë që të mos themi kushte fizike apo mendore. Flas vetëm për këtë term. Pjesa tjetër më pas është riformuluar qartë.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord. Miratohet neni 72 bashkë me riformulimin.

Kalojmë te kapitulli. Diku thoni titulli, diku thoni kapitulli. Vlerësimi i veprimtarisë së magjistratëve, parimet e përgjithshme. Te neni 73 qëllimi i vlerësimit të magjistratëve.

**Vasilika Hysi** – Është marrë në konsideratë vetëm një shtesë që ne kemi kërkuar të shtohet fjala “magjistrat” që të kuptohet se veprimtaria e cilit vlerësohet, meqenëse është edhe në titull. Kjo është marrë në konsideratë të fjalës hyrëse e nenit 73. Gjërat e tjera janë korrekte.

**Fatmir Xhafaj** - Dakord.

Miratohet me ndryshimin.

Neni 74 “Parimet e vlerësimit”.

**Vasilika Hysi** – Është në rregull, sikurse ka ardhur nga grupi i punës.

**Fatmir Xhafaj** - Nuk keni vërejtje apo sugjerime?

**Vasilika Hysi** - Jo.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord, miratohet siç është.

Neni 75 “Subjektet e vlerësimit”.

**Vasilika Hysi** – Te neni 75 ne kemi pasur komente për pikat 3 dhe 5 lidhur me vlerësimin dhe me qartësimin e tyre. Në këtë kuadër unë e gjej shqetësimin e ngritur të reflektuar, sepse në draftin ose në projektin e sjellë paragrafi i pestë i këtij neni është fshirë. Ai krijonte paqartësi dhe në këtë mënyrë është më e qartë përmbajtja e këtij ligji.

**Fatmir Xhafaj** - Dakord

Miratohet neni 75 me ndryshimet e bëra.

Vazhdojmë me kreun e II-të. Seksioni i I-rë.

Neni 76.

**Vasilika Hysi** – Lidhur me nenin 76 kam ngritur dy kërkesa për riformulim. Germa “a” ku thuhet: “Vlerësimi kryhet sipas kritereve të mëposhtme: “aftësisë gjyqësore dhe prokuroriale”.

Për germën “ç” ku thuhet: “aftësitë njerëzore”.

Grupi i ekspertëve ka marrë në konsideratë sugjerimin e dytë të ngritur nga ana ime për “aftësitë njerëzore”, duke i zëvendësuar me “aftësitë personale”, por nuk ka reflektuar ndryshimin e terminologjisë së përdorur të germa “a”: “aftësi gjyqësore dhe prokuroriale”. Unë e kuptoj shumë mirë se çfarë janë aftësitë gjyqësore dhe prokuroriale, sepse janë zhvilluar në nenet 77 dhe 78, nenet pasardhëse, por në gjuhën shqipe ne nuk e përdorim termin “aftësi prokuroriale”, sepse në mendimin tim “aftësitë prokuroriale” janë aftësitë profesionale të prokurorit, arsyetimi ligjor, por po të thuhet aftësi prokuroriale, mund të jenë dhe aftësitë e kryetarit të prokurorisë për të drejtuar, aftësitë e menaxhimit të një prokurorie, të drejtimit të një seksioni.

Kemi pasur dhe sot para se të fillonim mbledhjen një diskutim të gjerë me zonjën Agnes, por nuk kemi rënë dakord. Zonja Agnes solli argumente se ky shqetësim i ngritur nga ana ime ka qenë pjesë e debatit edhe në grupin e punës që ka hartuar projektligjin dhe nuk kanë gjetur term tjetër, përveç atij që thuhet “aftësi prokuroriale”. Nuk e di se cilat do të ishin termat e rinj, por në fjalorin shqip do të hyj një term, i cili përdoret në Kosovë, por nuk është në gjuhën shqipe dhe në “Fjalorin e Gjuhës Shqipe” “prokuroriale”. Ndoshta zonja Agnes mund të na japë më shumë...

**Fatmir Xhafaj** - Nuk ka rëndësi, pse i bini kaq gjatë? Gjeni një term tjetër.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ta gjejë kryetari? Dakord.

Miratohet me ndryshimin dhe me detyrën e shtëpisë që unë të gjej termin

Faleminderit.

Neni 77.

**Vasilika Hysi** - Lidhur me nenin 77 merret dhe analizohet se çfarë do të thotë aftësi gjyqësore. Nuk kam ndonjë gjë me përmbajtjen e këtij neni në parim. Te pika 1, ku thuhet: “Aspekti i njohurive ligjore, vlerësohet duke u bazuar në aftësinë e gjyqtarit për të marrë...”, ndoshta do të ishte më mirë: “Aftësitë gjyqësore vlerësohen me anë të kapaciteteve profesionale të gjyqtarit, në drejtim të njohurive”. Të dyja variantet mund të qëndrojnë. Mund të bëhet një qartësim kur do të redaktohet projektligji në fund fare, për ndonjë fjalë parazite që mund të ketë.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

Neni 78.

**Agnes Bernhard** - *(flet anglisht)* Do të doja të bëja një vërejtje të përgjithshme në lidhje me këtë kapitull. I gjithë ky kapitull është performuar nga një grup pune, nga Ministria e Drejtësisë, pothuajse një vit më parë. Në këtë grup pune kishte gjyqtarë, prokurorë dhe përfaqësues nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë që parashikonin kalimin e ligjit në parlament. Grupi i punës kishte përpunuar plotësisht materialin, e përshtati atë në strukturën e re të drejtësisë, duke mos iu referuar më Inspektoratit, por Këshillit dhe kështu me radhë. Ky kapitull bazohet në një projektligj që tashmë i ka kaluar parlamentit dhe kjo është edhe arsyeja pse është kaq i përpunuar në detaje, sepse është një produkt i një procesi të gjatë me shumë grupe interesi, përfshirë Këshillin e Europës dhe ekspertë nga Këshilli i Europës.

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit, zonja Bernhard!

Në mbështetje të komentit që bëtë ju, mund të themi se ligji “Për vlerësimin e gjyqtarëve” është paraqitur në Komisionin e Ligjeve për t’u planifikuar për t’u shqyrtuar, por duke qenë se lindte domosdoshmëria që edhe ai të ishte pjesë e kësaj reforme, u la për t’u përfshirë këtu, është pikërisht sot radha që ta shqyrtojmë këtë element kryesor të këtij ligji, t’i shikojmë të pasqyruara te ligji “Për statusin”.

Kjo do të na e bëjë më të lehtë shqyrtimin.

Jeni dakord me nenin 77?

Miratohet.

Neni 78.

**Vasilika Hysi** - Jam dakord edhe me nenin 78.

**Fatmir Xhafaj** - Më falni, që të kuptohemi, meqenëse më latë detyrë shtëpie, a mund ta bëj detyrë klase?

Ke neni 76, keni thënë: “aftësi gjyqësore ose prokuroriale”, por mund ta bëni: “aftësive si gjyqtarë ose si prokurorë”? Është e njëjta gjë?

**Agnes Bernhard** -*(flet anglisht)* Kapaciteti, aftësia si gjyqtarë ose prokurorë përfshin më shumë aspekte. Një aspekt i ngushtë, për shembull është mënyra se si gjykoj, por si gjykatës që jo vetëm gjykon, por duhet të dish sesi të komunikosh, si të ndash mendimet me palët, të krijosh një ambient pune që është i përshtatshëm për të gjithë, përfshirë edhe aspektet menaxheriale, gjithashtu. Pra, profesionalizmi dhe aftësitë profesionale të një gjykatësi janë shumë më të gjera. Katër termat e përdorur këtu janë nën kategoritë brenda kapaciteteve dhe aftësive të gjyqtarit dhe të prokurorit.

**Fatmir Xhafaj** – “...profesionale si prokuror”. Kaq. Aftësitë profesionale kemi këtu.

**Agnes Bernhard** - *(flet anglisht)* Ajo që dua të them me aftësi të gjyqarit, aftësi gjyqësore do të thotë që janë njohuritë ligjore dhe argumentimi, arsyetimi i tij për të marrë vendime. Aftësitë e një gjyqtari duhet të jenë shumë më të gjera se sa kaq, duhet të ketë etikën, aftësi organizuese, duhet të jetë social, duhet të ketë aftësi të tjera shtesë personale dhe profesionale, të cilat përfshihen në këtë gamë të gjerë të aspektit të performancës profesionale të një gjykatësi. Prandaj e kam pak të vështirë të them se këto janë aftësitë e një gjykatësi, sepse aftësitë e një gjykatësi janë shumë më të gjera se kaq.

**Fatmir Xhafaj**- Ky nen është për aftësitë profesionale dhe vlerësimin profesional të tij, apo jo?

**Agnes Bernhard** - *(flet anglisht)* I gjithë kapitulli është për performancën profesionale, pra profesionalizmi janë kapacitetet e mia për të gjykuar, njohuritë e mia gjyqësore, si të strukturoj një vendim. Kjo është një pjesë e kapacitetit tim profesional, por unë nuk jam një gjykatës i mirë, vetëm nëse kam shumë njohuri, shkruaj mirë, gjykoj mirë dhe kjo të më bëjë mua një gjyqtar shumë të mirë.

**Fatmir Xhafaj** - Termi “aftësi gjyqësore dhe prokuroriale” lidhur me germën “a” të nenit 76 kanë të bëjnë kryesisht vetëm me aftësitë profesionale. Aftësitë organizative, të etikës dhe të organizmit janë çështje të tjera.

Ideja është për t’i titulluar ndryshe, për ta specifikuar ndryshe.

**Vasilika Hysi** - Nëse më lejoni, dua të them se më duket i drejtë gjykimi i kryetarit, sepse ne themi që vlerësimi bëhet në bazë të katër cilësive. E para, është aftësitë organizative janë vënë...

**Fatmir Xhafaj** - Mund t’i jepni te përkufizimet se çfarë kuptoni me “aftësi gjyqësore: dhe çfarë kuptoni me “aftësi të prokurorit”. Jeni dakord me nenin 78? Dakord.

Neni 79.

**Vasilika Hysi** – Te ky nen nuk ka ndryshime, sepse sqarohen një nga një të gjitha kriteret e vlerësimit.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

Neni 80.

**Vasilika Hysi** - Nuk kam komente. Janë të elaboruara mirë edhe nga pikëpamja e teknikës legjislativë.

**Fatmir Xhafaj** - Neni 81.

**Vasilika Hysi** – Te ky nen është i vetmi ndryshim: “aftësitë njerëzore”, të bëhet “aftësitë personale” dhe është reflektuar propozimi ynë.

**Fatmir Xhafaj** - Unë do t’i shkoja logjikës së zonjës Agnes se janë shumë më të gjera, sepse njeriu bën shumë gjëra që nuk përfshin ky ligj.

Jemi dakord me rregullimin që keni bërë te neni 81.

Neni 82. “ Burimet e vlerësimit”.

**Vasilika Hysi** - Është rregullim i teknikës legjislative dhe është reflektuar. Unë kam një pyetje, për germën “b”, kur thuhet që vlerësimi i magjistratit bazohet në të dhënat statistikore, që e kanë rregulluar, ku janë të gjitha të dhënat, treguesit e punës së një magjistrati.

**Fatmir Xhafaj** - Jemi dakord me nenin 82 me ndryshimet e bëra.

Neni 83. “ Nivelet e vlerësimit”.

**Vasilika Hysi** - I vetmi koment që kam është përdorimi i termit “shkëlqyeshëm”, te vlerësimi i parë, ku thuhet “shkëlqyeshëm” në rastin e veprimtarisë etike dhe profesionale me cilësi jashtëzakonisht të lartë. Fjalët “jashtëzakonisht e lartë” më duken të ekzagjeruara, por gjatë diskutimit përpara se të hynim në mbledhje nuk kemi rënë dakord me zonjën Agnes, e cila ka komentet e saj, pse duhet lënë ky term dhe çfarë do të nënkuptojë në realitetin tonë, pasi qenka një standard që e kanë edhe vendet e tjera.

**Agnes Bernhard** - (*flet anglisht*) Ideja është që të identifikohen midis të mirëve ata që janë me të vërtetë të shquar, të dalluar midis më të mirëve për të garantuar që janë me të vërtetë shumë të veçantë, ndoshta janë pak tre-katër në të gjithë vendin, por duhet të kenë përparësi në zhvillimin e karrierës. Duhet të garantohet që ata, të cilët shfaqin, bëjnë një performancë të jashtëzakonshme janë me të vërtetë të dalluar dhe duhet të kenë përparësi gjithandej, kur vjen puna te promovimi, rritja në detyrë dhe kështu me radhë. Nuk duhet të mbështetemi vetëm në faktin që në të ardhmen të gjithë do të jenë jashtëzakonisht të mirë. Mendoj që shumica e gjyqtarëve janë të mirë, mesatarë, por disa prej tyre janë shumë të mirë ose sipër mesatares dhe tre ose katër janë jashtëzakonisht të mirë, të spikatur. Nëse kjo skemë me të vërtetë do të aplikohet, atëherë e bën skemën e vlerësimit bazën për promovimin në detyrë në bazë të meritave dhe zhvillimin e karrierës në bazë të meritës.

**Fatmir Xhafaj** - Me shpresë të Zotit, që nuk do të jenë të gjithë të shkëlqyeshëm në këtë vend. Kur ju të mos jeni më këtu, unë dy-tre vjet më mbrapa, do të mbaj premtimin se do t’ju

dërgoj tabelë të vlerësimit të gjyqtarëve dhe të prokurorëve. Tre vjet pasi të keni ikur ju, besoj se do të rrinë gjatë dhe do të dëshiroja shumë të qëndroni gjatë këtu, për hir të së vërtetës.

Neni 83, me ndryshimet, duke reflektuar termin e “aftësive gjyqësore ose prokurale”, ose të prokurorisë e keni shkruar këtu dhe është një lëmsh, por duke e rregulluar dhe duke e përshtatur.

Pra, jemi dakord me nenin 83 me ndryshimet.

Neni 84 “ Kriteret për vlerësimin e veprimtarisë së kryetarit”

**Vasilika Hysi** - Zoti kryetar, këtu fillon seksioni i II-të “Vlerësimi i veprimtarisë së kryetarit”. Lidhur me këto nene, 84, 85, 86, 87 dhe 88 nuk ka ndryshime, por e vetmja kërkesa që kisha bërë ishte që të riformulohej termin “aftësitë e komunikimit” në vend të fjalës “komunikuese”, dhe “aftësitë organizative” në vend të fjalëve “organizuese” dhe “kanë reflektuar”.

Të gjitha këto nene...

**Fatmir Xhafaj** – Pse e ke kërkuar ndryshimin nga “aftësi organizuese” në “organizuese”?

**Vasilika Hysi** – Jo, ishte “organizuese”...

**Fatmir Xhafaj** – Ku është ndryshimi?, do të pyeste dikush këtu në sallë, që e lexon fjalorin shpesh.

**Agnes Bernhard** – *(flet anglisht)* Në fakt as në shqip nuk kishte përputhje, sepse për gjyqtarët ne përdorëm termin tjetër. Kështu që ishte për shkak të pasjes së një uniformiteti.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Vasilika Hysi** – Po, edhe neni 85, me ndryshimet. Edhe neni 86.

**Fatmir Xhafaj** – Edhe neni 86, dakord!

**Vasilika Hysi** – Edhe neni 87.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 87, dakord! Neni 88, dakord!

**Vasilika Hysi** – Këtu te neni 88 kam diçka. Në qoftë se do t’ju bjerë në sy, niveli i vlerësimit të gjyqtarëve ndryshon nga niveli i vlerësimit të kryetarit. Te niveli i vlerësimit të gjyqtarëve kishim një shkallë më të detajuar. Te kryetarët vlerësimi është vetëm në tri shkallë. Pyetja ime është: pse nuk kemi të njëjtin standard apo shkallë të nivelit të vlerësimit të magjistratëve.

Zonja Agnes, edhe gjatë diskutimit paraprak, ka sjellë argumentet e saj, të cilat mund t'i bëjë publike në këtë mbledhje.

**Fatmir Xhafaj** – S'ka rëndësi. Biem dakord me këtë.

**Vasilika Hysi** – Do ta dijë pse, që të mos kemi komente edhe më pas.

**Agnes Bernhard** – (*flet anglisht*) Gjyqtarët, në fakt, janë duke u vlerësuar nën skemën e gjyqtarëve, ndërsa kryetarët janë të vlerësuar edhe për performancën e tyre si kryetarë. Kjo është diçka shtesë. Pra, ne kemi nevojë për vlerësimin e tyre si kryetarë, me qëllim që të sigurohemi që, ata kryetarë të cilët nuk e kanë bërë detyrën siç duhet, nuk duhet të riemërohen për një mandat të dytë.

Kjo nuk ka të bëjë me aspektin e zhvillimit të mëtejshëm të karrierës së tyre. për këtë arsye, ne menduam e do të ishte më mirë, që të kishim një skemë më të thjeshtë vlerësimi, thjesht si kryetarë.

**Fatmir Xhafaj** – E mbyllim këtu këtë kapitull. Vazhdojmë me nenin 89: “Periudha e vlerësimit”. Për gjithë këto, “Dispozitat e përgjithshme”, “Procedura e vlerësimit”, nuk ke ndonjë gjë të veçantë apo jo?

**Vasilika Hysi** – Po, zoti kryetar! Sikurse e thatë, e tha edhe zonja Agnes, por ju e konfirmuat, kjo ka qenë pjesë e një ligji, që është depozituar tashmë në Kuvend, është punuar, është parë edhe nga Ministria e Drejtësisë, nga Drejtoria e Kodifikimit.

**Fatmir Xhafaj** – Në rregull, atëherë e kalojmë.

**Vasilika Hysi** – Po. Te neni 89 kam vetëm një pyetje për zonjën Agnes. Nuk ka ndonjë ndryshim në themel, por në paragrafin e katërt, po të lexoni, thuhet: “Magjistrati i cili ka ushtruar funksionin si anëtar i një këshilli, nuk do të vlerësohet”. Pyetja ime është: pse të mos vlerësohet? Pse? Sepse ne kemi dy skema të ndryshme të niveleve të vlerësimit. Për magjistratin vlerësimi është më i detajuar: i mirë, shumë i mirë e të tjerë, ndërsa për anëtarët e këshillit dhe për kryetarin, ne e kemi vlerësimin me një skemë tjetër, që ju sapo e sqaruat.

Zonja Agnes ka një argument se përse magjistrati, i cili ka ushtruar funksionin si anëtar i një këshilli, nuk do të vlerësohet.

**Fatmir Xhafaj** – Po. Komenti juaj.

**Agnes Bernhard** – (*flet anglisht*) Këtu është çështja se kush i vlerëson vlerësuesit. Këshilli është vlerësuesi, por mbetet pyetja se kush do t'i vlerësojë vlerësuesit. Kjo tregon se, në njëfarë pike, vlerësimi ndalon, përfundon. Kjo është arsyeja pse kjo dispozitë parashikon se

vlerësuesit nuk do të vlerësohen më tej. Nuk është një praktikë që ndodh në vendet e tjera, arsye për të cilën nuk e kemi parashikuar as këtu.

**Vasilika Hysi** – Nëse ju kuptova korrekt, një magjistrat që është anëtar i këshillit të gjykatës së vet, nëse do të ngrihet në detyrë, me çfarë vlerësimi do të shkojë? Ai si magjistrat do të vlerësohet, besoj. Vlerësimin si magjistrat do ta marrë, por ndërkohë, krahas detyrës së magjistratit ka pasur edhe një detyrë tjetër në këshill. Pse të mos vlerësohet edhe performanca e tij si anëtar i këshillit?

**Fatmir Xhafaj** – Po pra, e ke te pika 4.

**Vasilika Hysi** – Atë po kërkoj. Nuk e vlerëson, pra. Te pika 4 thuhet se nuk vlerësohet. Pra, ai mund të jetë shumë i mirë në gjykime, por nuk ka qenë i mirë në këshillin e gjykatës. Kjo, mendoj unë, është minus për një magjistrat, i cili mund të jetë i mirë në profesion, por nuk është në aftësitë organizative.

**Agnes Bernhard** – *(flet anglisht)* Në qoftë se ai ka ushtruar detyrën si anëtar i këshillit, duhet të punojmë përsëri si magjistrat ose minimumi si gjyqtar, përpara se të ngrihet në detyrë. Kjo ishte një garanci që ne e kemi nxjerrë në këtë ligj. Pra, para se ai të jetë anëtar i këshillit, ai është vlerësuar si gjyqtar, ndërsa më pas, që të jetë kandidat për t'u ngritur në detyrë, ai duhet të shërbejë përsëri dy vjet si gjyqtar. Gjatë këtyre dy viteve si gjyqtar, ai mund të kërkojë një vlerësim të përshpejtuar, nëse kjo ndodh menjëherë pas këtyre dy vjetëve, nëse ka kaluar, le të themi, një kohë trevjeçare apo nga periudha kur ai është vlerësuar. Prandaj vlerësimi mund të bazohet edhe në vlerësimin para se të ketë qenë anëtar i këshillit, si dhe vlerësimin pasi ka qenë anëtar i këshillit. Nëse ai ka pasur me të vërtetë një performancë shumë të keqe kur ka qenë anëtar i këshillit, ose ka bërë diçka të tillë, sa ndaj tij është marrë një masë disiplinore, sigurisht që edhe kjo gjë duhet të përfshihet në vlerësimin e tij.

Kështu, unë mendoj se, si një efekt afatgjatë, nëse ai ka pasur gjithashtu edhe një performancë të keqe gjatë kohës që ai ka pasur detyrën si anëtar i këshillit, sigurisht që kjo do të ketë ndikim në vlerësimin që i jepet edhe si gjyqtar.

**Vasilika Hysi** – Zoti kryetar, do të sugjeroja që në paragrafin e katërt, fjalinë e dytë ta ndanim paragraf më vete. Kur thoni që “Këshilli miraton rregulla më të detajuara për renditjen e tyre në procedurat e transferimit dhe ngritjes në detyrë”, të jetë një paragraf më vete. Në këtë mënyrë nuk bëj atë lidhjen që unë bëj...

**Fatmir Xhafaj** – Duke marrë në konsideratë edhe shërbimin e tij në këshill.



**Vasilika Hysi** – Ta kalojmë këtë: “Këshilli miraton rregulla të detajuara”.

**Fatmir Xhafaj** – Po, dakord jam, por duke marrë në konsideratë edhe periudhën e shërbimit, sepse do të bëhet vlerësim për punën e tij. Dakord? Në rregull.

Neni 90. Dakord?

**Vasilika Hysi** – Neni 90, dakord!

**Fatmir Xhafaj** – Neni 91. Dakord?

**Vasilika Hysi** – Neni 91, dakord!

**Fatmir Xhafaj** – Neni 92...

**Vasilika Hysi** – Te neni 92 ka disa redaktime të vogla në paragrafë...

**Fatmir Xhafaj** – Dakord me ndryshimet e bëra, të teknikës.

**Vasilika Hysi** – Po, të teknikës janë.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 93. Dakord?

**Vasilika Hysi** – Te neni 93 ka një ndryshim të vetëvlerësimit. Unë kam bërë një pyetje, se kush i përzgjedh vendimet dhe kërkesat për gjykim, kur bëhet vetëvlerësimi i magjistratit. Sepse m’u duk një çikë e çuditshme që vetë magjistrati t’i çojë komisionit të vlerësimit dy vendime dhe dy kërkesa për gjykim, por zonja Agnes ka një argument se përse. Risia e këtij neni, zoti kryetar, është se për herë të parë magjistratët do të bëjnë vetëvlerësimin tyre.

**Fatmir Xhafaj** – Në rregull. Dakord.

**Agnes Bernhard** –(*flet anglisht*) Magjistrati, së bashku me vetëvlerësimin, dhe kjo rregullohet në nenin 91, ka mundësinë të paraqesë para këshillit ato vendime, me të cilat si mendon se mund të provojë më së miri se ka performuar shumë mirë. Këto janë vendime, të cilat janë përzgjedhur nga ai vetë. Sigurisht, me qëllim që të mos kemi një përzgjedhje subjektive të çështjeve, është një tjetër dispozitë, e cila parashikon se si të gjejmë ato çështje, të cilat mund të vendosen me short, të cilat mund të japin një vlerësim të përgjithshëm të gjyqtarit gjatë gjithë periudhës së vlerësimit.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 94. Dakord?

**Vasilika Hysi** – Neni 94 ka të bëjë me një seksion të ri të procesit të vlerësimit. Veçoria e këtij seksioni, që unë e diskutova edhe me zonjën Agnes, është se ka rregulla shumë të detajuara të të gjithë ecurisë së procesit të vlerësimit, duke filluar që nga përgatitja e dokumentacionit, dosja e të tjera.

Sa i takon pyetjes sime se përse keni kaq shumë rregulla të detajuara, të përfshira në ligj, dhe nuk ia lini këshillit, zonja Agnes, me të drejtë tha se kjo është një praktikë e re, dhe vlerësimi i magjistratëve është proces shumë i rëndësishëm, sepse mbi bazën e këtij vlerësimi bëhet transferimi, ngritja në detyrë, promovimi, ndaj nuk duhet lënë në vendimet e këshillave, por duhet të jenë të sanksionuara në ligj, në mënyrë të detajuar.

Megjithatë, në qoftë se zonja Agnes ka...

**Fatmir Xhafaj** – Po çfarë ka këtu? Pse duhet të bëjmë debat?

**Vasilika Hysi** – Jo, për ta ditur, sepse ka shumë rregulla të detajuara.

**Fatmir Xhafaj** – Shumë mirë që ka rregulla.

**Vasilika Hysi** – Në rregull. Në qoftë se edhe ju jeni dakord...

**Fatmir Xhafaj** – Të jemi të gjithë dakord, sepse çfarë po ndodh sot me Këshillin e Lartë të Drejtësisë, që i krijon rregullat sipas qejfit të kryetarit të këshillit apo ku një grup anëtarësh dominojnë jetën e Këshillit të Lartë të Drejtësisë apo të stafit të tyre atje, që bëjnë politika klienteliste. Shumë mirë që kemi rregulla të detajuara në ligj, sepse nesër askush nuk ka mundësi abuzimi me aktet nënligjore. S'ka asgjë të keqe.

Po të kishin krijuar precedent zakone të shëndetshme, nuk do të kishim nevojë për ligje kaq të hollësishme. Problemi është se zakonet tona nuk janë aq fort të shëndetshme, kështu që jemi të detyruar t'i vendosim në ligj, që ato të kthehen në normë e praktikë në precedent pune, e pastaj mund ta lehtësojmë ligjin. Por ne jemi në këtë fazë, në këtë pjekuri politike dhe institucionale.

Neni 94. Dakord!

Neni 95. Dakord!

Neni 96. Dakord!

**Vasilika Hysi** – Dakord, me disa redaktime të teknikës legjislative.

**Fatmir Xhafaj** – I shohim ato. Dakord jemi.

Neni 97. Dakord!

**Vasilika Hysi** – Po, neni 97, dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 98. Dakord!

**Vasilika Hysi** – Dakord!

**Fatmir Xhafaj** – Neni 99.

**Vasilika Hysi** – Dakord!

**Fatmir Xhafaj** – Fiks për 99-sha është ky neni. Në rregull. Dakord!

Neni 100: “Vendimi për vlerësimin”.

**Vasilika Hysi** – Po. Dakord jemi!

**Fatmir Xhafaj** – Neni 101: “Procedura e vlerësimit për kryetarët”.

**Vasilika Hysi** – Dakord!

**Fatmir Xhafaj** – Neni 102: “Vlerësimi me kërkesë”.

**Vasilika Hysi** – Unë do të doja që ta ndërprisnim këtu. Nuk e di nëse zonja Agnes është...

**Fatmir Xhafaj** – Neni 102, pra.

**Vasilika Hysi** – Jo. Deri te neni 102.

**Fatmir Xhafaj** – Po pra, ta mbarojmë.

Neni 102. Dakord!

Për të vazhduar me nenin 103. Pse duhet ta ndërpresim?

**Vasilika Hysi** – Unë personalisht nuk kam ndonjë koment. Nëse ekspertët janë dakord për të vazhduar... Në lidhje me pjesën e procedimit disiplinor, duke filluar që nga neni 105, kemi disa pyetje.

**Fatmir Xhafaj** – Vazhdojmë me nenin 103: “Raporti i vlerësimit”. Dakord?

Neni 104: “Raporti periodik për sistemin e vlerësimit”. Dakord?

E ndërpresim te neni 105: “Parimet e procedimit disiplinor”.

**Vasilika Hysi** – Po.

**Fatmir Xhafaj** – Keni shumë pyetje për të bërë. në rregull.

**Vasilika Hysi** – Janë disa pyetje. Në rast se ekspertët janë të gatshëm që të vazhdojmë, unë jam dakord. nëse zonja Agnes dhe ekspertët janë dakord që ne të vazhdojmë.

**Agnes Bernhard** – (*flet anglisht*) A mund të vazhdojmë me hetimin, sepse atje kemi bazat për të proceduar, apo ta lëmë për nesër, ndoshta?

**Vasilika Hysi** – Ta vazhdojmë nesër?

**Fatmir Xhafaj** – Po, po, dakord jam. Të lëmë një orar. Të enjten është seancë, por... Në rregull, do t’ju njoftojmë. Dakord? Që t’ju lëmë kohë. Në rregull?

(*Ndërhyrje pa mikrofon*)

Në rregull! Dakord! Do t’ju njoftojmë në lidhje me orarin për nesër, pasi të biem dakord, duke parë edhe ngarkesën që ka seanca plenare, pa e dëmtuar.

Në rregull! Shumë faleminderit! E ndërpresim këtu. E di që jeni lodhur, por nuk është përgjegjësia juaj, që jeni lodhur, rilodhur, më saktë. Ky është një ligj i vështirë, në tërësinë e tij, ndaj është e kuptueshme. Është ligj voluminoz, është ligj i rëndësishëm, ku përthyhen shumë interesa, shumë dëshira. Natyrisht ka edhe standarde shumë të qarta, që duhen reflektuar.

Në rregull! E mbyllim këtu, për të vazhduar pastaj me nenin 105.

Faleminderit!

## **MBYLLET MBLEDHJA**

*Shënim: Diskutimet e zhvilluara në gjuhën angleze, janë reflektuar të përkthyer në këtë procesverbal. Përkthimi është kryer nga stafi teknik i angazhuar pranë Komisionit të Posaçëm për Reformën në Sistemin e Drejtësisë*

